


Raporti Nr. 37594-AL

Shqipëria

Rishikim i Sistemit të Sigurimeve Shoqërore

Dhjetor 2006

Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor
Njësia e Evropës Juglindore
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore



Dokument i Bankës Botërore

VITI FISKAL
1 janar – 31 dhjetor

EKUIVALENTËT E MONEDHËS
(kursi i këmbimit me datë 30 nëntor 2006)

Njësia monetare
Lek

Njësitë ekuivalente
US\$1 = 94.73 Lek

PESHAT DHE MASAT
sistemi metrik

SHKURTIME DHE AKRONIME

ECA	Evropa dhe Azia Qendrore
GDP	Produkti i Brendshëm Bruto
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
SII	Instituti i Sigurimeve Shoqërore

Zëvendës President:	Shigeo Katsu
Drejtoreshë për Shqipërinë:	Orsalia Kalantzopoulos
Drejtor Sektorial:	Tamar Manuelyan Atinc
Menaxher Sektorial:	Hermann von Gersdorff
Drejtoreshë e Grupit të Punës:	Anita Schwarz

DY FJALË FALENDERIMI

Ky dokument politikash është hartuar nga një ekip i Bankës Botërore i drejtuar nga Anita Schwarz (task manager dhe autore, ECSHD). Analiza e të dhënave u siguria nga Montserrat Pallares-Miralles (HDNSP). Udhëzimet dhe komentet i takojnë znj. Lorena Kostallari (ECSHD). Ky dokument u hartua nën supervizionin e z. Hermann von Gersdorff, Manaxher i Sektorit për Mbrojtjen Sociale (ECSHD) dhe z. Arup Banerji, Manaxher i Sektorit për Ekonomikën e Zhvillimit Njerëzor (ECSHD), me mbështetjen e znj. Orsalia Kalantzopoulos, Drejtore për Shqipërinë (ECCU4). Përpunimi i dokumentit u bë nga Carburra Laurente.

Oponentë ishin z. Rafael Rofman, specialist i lartë për mbrojtjen sociale (LCSHS) dhe znj. Asta Zviniene, specialiste e lartë për mbrojtjen sociale (HDNSP). Komentet e tyre bashkërisht me komentet e kolegëve të tjerë mbi dokumentin konceptual dhe variantet fillestare ndihmuan shumë në përgatitjen e këtij dokumenti përfundimtar.

Megjithatë, çdo gabim i mundshëm mbetet përgjegjësi e autores.

PASQYRA E LËNDËS

FAQE

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	i
I. HYRJE	1
II. KUSHTET DEMOGRAFIKE DHE ATO TË TREGUT TË PUNËS	2
III. PËRSHKRIM I PARAMETRAVE TË SISTEMIT SHQIPTAR TË PENSIONEVE	6
IV. PARASHIKIME PËR SISTEMIN AKTUAL TË PENSIONEVE, 2004-2075	13
V. OPCIONET E POLITIKAVE.....	21
VI. SIGURIMET AFATSHKURTRA.....	35
VII. PAGESA E PAPUNËSISË.....	36
VIII. SIGURIMET SHËNDETËSORE	38
IX. KONKLuzionET	40
ANEKSET	41
REFERENCAT.....	46

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE

Figura 2.1: Përqindja e popullsisë mbi 65 vjeç midis vendeve të ECA-s	2
Figura 2.2: Koeficientët e varësisë së sistemit në Shqipëri krahasuar me pjesën tjetër të rajonit të ECA-s	4
Figura 3.1: Përqindjet e kontributeve për pensionet në Shqipëri në krahasim me vendet e OECD-së.....	7
Figura 3.2: Përqindjet e kontributeve në sistemin shqiptar të pensioneve në krahasim me vendet e tjera në tranzicion	7
Figura 3.3: Moshat e daljes në pension në Shqipëri në krahasim me vendet e OECD-së në vitin 2004	8
Figura 3.4: Niveli i brendshëm i kthimit për Individët me Nivele të ndryshme të ardhurash në sistemin urban të pensioneve.....	9
Figura 3.5: Pensionet e marra si përqindje e pagës së fundit personale për individë me nivele të ndryshme të ardhurash.....	10
Figura 4.1: Koeficienti i varësisë së moshës së thyer parashikuar për Shqipërinë, 2004-2072	14
Figura 4.2: Koeficientët e varësisë së sistemit të parashikuara në sistemet e pensioneve urbane dhe rurale në Shqipëri	15
Figura 4.3: Numri i parashikuar i pensionistëve të moshuar në të ardhmen në krahasim me popullsinë e moshuar në Shqipëri	15
Figura 4.4: Balancat e parashikuara fiskale të sistemit të pensioneve sipas legjislacionit në fuqi.....	16
Figura 4.5: Ndryshimi i parashikuar për përfitimet në rast se rritjet vjetore përcaktohen me ligj	17
Figura 4.6: Balanca e parashikuar fiskale në rast se përfitimet e pensioneve indeksohen plotësisht për pagat	19
Figura 4.7: Përfitimet e parashikuara në rast se të gjitha parametrat e përfitimeve do të indeksoheshin sipas pagës	19
Figura 5.1: Balanca e parashikuar fiskale për sistemin urban të pensioneve sipas Opcionit 1	24
Figura 5.2: Përfitimet e parashikuara për pensionistët me pension pleqërie sipas Opcionit 1	25
Figura 5.3: Përqindja e të moshuarve që mbulohen nga sistemi i pensioneve me kalimin e kohës, sipas Opcionit 1	26
Figura 5.4: Nivelet e brendshme të kthimit për Individët me nivele të ndryshme të ardhurash sipas Opcionit 1	26

Figura 5.5: Përfitimi i pensionit krahasimisht me pagën e fundit personale për individë me të ardhura të ndryshme, sipas Opcionit 1	27
Figura 5.6: Kostot e parashikuara fiskale sipas Opcionit 2 me eliminimin total të kontributeve në vitin 2007	29
Figura 5.7: Kostot e parashikuara fiskale sipas Opcionit 2A	29
Figura 5.8: Përfitimet e parashikuara sipas Opcionit 2 dhe 2A në krahasim me skenarin bazë të pensioneve urbane të indeksuara për pagën	30
Tabela 2.1: Tregues demografikë dhe financiarë të sistemit shqiptar të pensioneve	3
Tabela 3.1: Parametrat e skemës së pensioneve të sektorit urban në Shqipëri	6
Tabela 4.1: Supozime për pjellorinë dhe sjelljen që janë përdorur në parashikimet	13
Tabela 4.2: Supozimet makroekonomike	16
Tabela 5.1: Parametrat e përdorur për të ilustruar Opcionin 1	23

LISTA E FIGURAVE DHE TABELAVE TË ANEKSIT

Figura A.1: Piramida e popullsisë për Shqipërinë në vitin 2004	42
Figura A.2: Piramida e parashikuar për popullsinë në Shqipëri në vitin 2075	42
Figura A.3: Kontribuesit në Sistemin Urban në Shqipëri si përqindje e kohortës specifike të popullsisë sipas moshës-gjinisë në vitin 2004	43
Figura A.4: Pensionistët e moshuar meshkuj në sektorin urban në vitin 2004	44
Figura A.5: Pensionistët me paaftësi në sektorin urban në vitin 2004	44
Figura A.6: Pensionistët të mbetur të ve, sektori urban, viti 2004	45
Tabela A.1: Jetëgjatësia e parashikuar dhe totali i pjellshmërisë për vite të ndryshme	43
Tabela A.2: Supozimet e përdorura në analizat e shpërndarjes	45

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sistemi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri ndeshet me shumë probleme, ndër të cilët jo më i vogli është niveli tepër i lartë i kontributeve, që renditet ndër më të lartët në Evropën Perëndimore. Format i fillestar i sistemit ishte gjithëpërfshirës, mbulonte risqet e moshës së tretë, paaftësitë, vdekjen e kryefamiljarit, sëmundjet afatshkurtra, lejen e lindjes, papunësinë dhe kosto të shëndetit. Këto përfitime financoheshin përmes kontributit të pagës (borderosë) dhe vlerësoheshin si nga ana e punëdhënësit ashtu edhe nga ana e punëmarrësit, por në shkallë të ndryshme për përfitime të ndryshme.

Megjithatë, Shqipëria si shumë vende të tjera të tranzicionit, ka përjetuar një rritje të nivelit të informalitetit të krahut të punës, gjë që ka sjellë të ardhura të kufizuara nga kontributet e pagave, ndërsa përballet me barrën e mbështetjes të disa brezave të të moshuarve, shumica prej të cilëve gëzojnë të drejtën e pensionit të plotë. Shqipëria ka aritur të shmangë një krizë financiare në sistemin e sigurimeve shoqërore duke kompresuar ndjeshëm përfitimet dhe duke kaluar fondet ndërmjet degëve të sigurimeve shoqërore. Kompresioni i përfitimeve ka çuar në probleme të tjera, duke qenë se individët duke e kuptuar se përfitimi i tyre do të jetë i ulët pavarësisht nga kontributi, zgjedhin të deklarojnë të ardhura më të ulta dhe e kalojnë pjesën më të madhe të karrierës së tyre të punësimit në sektorin informal. Në të njëjtën kohë, qeveria është përpjekur të rrisë nivelin e përfitimeve për përfituesit e pensioneve më të ulta, për pensionistët në zonat rurale me qëllim njehësimin e tyre me atë të pensionistëve në zonat urbane. Rrjedhimisht kanë lindur një numër pabarazish në sistemin e pensioneve, ku të punësuarve urbanë u kërkohet të paguajnë kontribute të larta për pensione të kufizuara, ndërsa të punësuarit në zonat rurale paguajnë kontribute të ulta dhe marini pensione më të ulta, por që janë relativisht shumë të larta në krahasim me atë ç'ka kanë paguar.

Kjo përzjerje aktuale e politikave mund të mos jetë e qëndrueshme për të ardhmen. Qeveria sapo ka ulur përqindjet e kontributeve me qëllim sigurimin e stimujve për të marrë pjesë në tregun zyrtar të punës. Kjo politikë ul të ardhurat për sistemin e pensioneve pa i dhënë zgjidhje strukturës së përfitimeve. Në vend të ruajtjes së strukturës së përfitimeve, qeveria faktikisht ka rritur përfitimet, duke rritur pensionet urbane si direkt, ashtu edhe përmes rillogaritjes që po bën aktualisht dhe duke rritur ndjeshëm pensionet rurale. Qeveria po konsideron ulje të mëtejshme të përqindjeve të kontributeve dhe rritje të mëtejshme të përfitimeve. Është e qartë që ulja e të ardhurave, ndërsa rriten përfitimet do të sjellë herët apo vonë probleme fiskale.

Qeveria shqiptare aktualisht e gjen veten në një udhëkryq. Politika aktuale po çon në deficite të ardhshme fiskale, në përfitime të ulta dhe në një përqindje të lartë të popullsisë të ekspozuar ndaj riskqeve sociale. Qeverisë i duhet të rregullojë sistemin e sigurimeve shoqërore në mënyrë të tillë që të eliminojë pengesat e ndryshme që janë futur në sistem si rezultat i përpjekjeve për të “arnuar” problemet sipas rasteve, ose i duhet ta anulojë sistemin dhe të përqëndrojë burimet fiskale tek masat për uljen e varfërisë. Në rast se qeveria zgjedh riparimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, sistemi që duhet të dalë si rrjedhojë duhet të jetë i vetëfinancueshëm pa subvencionet e stërmëdha që jepen aktualisht nga qeveria. Atëherë, qeveria

mundet t'i përqëndrojë burimet e veta fiskale për të siguruar lehtësimin e varfërisë për individët që nuk kanë mundësi të përfitojnë nga sistemi.

Sistemi i pensioneve përbën elementin më të madh në sistemin e sigurimeve shoqërore, si përsa i përket të ardhurave, ashtu edhe përsa i përket shpenzimeve. Rrjedhimisht, dokumenti përqëndrohet në sistemin e pensioneve. Në rast se qeveria merr vendimin për të kaluar drejt pensioneve sociale dhe për t'u larguar nga sistemi kontributiv i pensioneve do të ishte e vështirë të argumentohet ruajtja e degëve të tjera të sigurimeve sociale, siç janë sigurimet shoqërore. Nga ana tjetër, në rast se qeveria e ruan sistemin kontributiv të pensioneve duhet të ndërmeren vendime të veçanta nëse degët e tjera duhet të vazhdojnë të ekzistojnë dhe në rast se po në çfarë niveli kontributi dhe përfitimi.

Problemet kryesore të sistemit të pensioneve mund të përmblihen si më poshtë vijon:

- mbulesë e pamjaftueshme për të moshuarit në periudhën afatgjatë, duke i lënë 40% të të moshuarve në të ardhmen pa mundësi përfitimi nga sistemi i pensioneve si rrjedhojë e numrit të ulët të individëve në moshë punë që aktualisht kontribuojnë në sistem;
- rënie e ndjeshme e masës së përfitimeve si pasojë e lidhjes së pensionit maksimal me inflacionin;
- nivele të larta kontributive që shkurajojnë formalizimin e krahut të punës;
- mungesa e stimuljeve në formulën e përfitimit që individët të deklarojnë pagën e plotë gjatë gjithë moshës së tyre të punësimit; dhe
- mbifavorizim për të punësuarit ruralë dhe pensionistët.

Këto probleme mund të zgjidhen përmes reformimit të sistemit të pensioneve në mënyrë të tillë që përfitimet të mos ulen ndjeshëm në të ardhmen, që masa e kontributit të ulët disi, përmes eliminimit të mungesës së situmujve për të kontribuar dhe përmes trajtimit të të punësuarve rurale njësoj si të punësuarit urbanë në rast se zgjedhin të vazhdojnë të kontribuojnë në sistemin e pensioneve. Opcioni 1 në këtë dokument jep shembullin e një sistemi pensionesh që i plotëson të gjithë këta objektiva. Megjithatë, korrigjimi i këtyre problemeve nuk do të jetë i mjaftueshëm për të sjellë shumicën e krahut të punës që aktualisht punon në sektorin informal në atë formal. Duke e bërë sistemin kontributiv të pensioneve të vetëfinansueshëm pa mbështetje tjetër nga shteti, qeveria mund të çlirojë burime fiskale për të ofruar përfitime minimale për uljen e varfërisë për të gjithë individët që nuk kontribuojnë, qofshin në zonat rurale, apo në ato urbane.

Alternativa e paraqitur në Opcionin 2 është eliminimi tërësisht i sistemit kontributiv që automatikisht eliminon problemet nr. 3 dhe 4 të lart përmendur dhe sipas të cilit u jepet pension social individëve mbi një moshë të caktuar, si p.sh. 65 vjeç. Sipas këtij sistemi, të punësuarit ruralë dhe urbanë trajtohen njësoj, të gjithë janë të mbuluar nga sistemi dhe arrihet një farë niveli i uljes së varfërisë për personat që nuk janë në gjendje të punojnë si pasojë e moshës apo ndonjë sëmundjeje. Megjithatë, përfitimet do të ulen ndjeshëm duke e lënë sistemin publik të pensioneve të paafte për t'u ofruar individëve një mjet për të zbutur konsumin midis periudhave

të punësimit dhe papunësisë në jetë, në përgjithësi. Një instrument i tillë mund të sigurohej veçmas nga një sistem vullnetar pensioni, idealja do të ishte që ky sistem të administrohej nga sektori privat, por që të rregullohej dhe mbikqyrej nga shteti ku avantazhet fiskale për këtë formë afatgjatë të kursimeve ofrohen nga qeveria. Në rast se konstatimet e analizave të tregut financiar dhe rregullator nxjerrin në pah se tregut financiar shqiptar i mungon thellësia e mjaftueshme për të mbështetur një industri të fondeve private të pensioneve të mirë-rregulluar, individëve do t'u duhet të mbështeten tek çfarëdo instrumenti financiar që ekziston në treg, ose qeveria mund të shohë mundësinë e krijimit të një agjencie tranzitore publike, me një mandat të kufizuar, ose në kohë ose me plotësimin e disa kushteve të caktuara të politikave, pas të cilës periudhë agjencia të mund të privatizohet.

Këto janë variante komplet të ndryshme të së ardhmes së sistemit të pensioneve në Shqipëri. Asnjëri nuk është i gabuar, ose i drejtë; të dy kanë avantazhe dhe disavantazhe dhe vende të ndryshme në botë kanë bërë zgjedhje të ndryshme në lidhje me këto variante. Ky dokument parashtron implikimet e këtyre zgjedhjeve dhe e lë në dorë të politikë-bërësve shqiptarë të vendosin se cila prej këtyre rrugëve i shkon më shumë për shtat të ardhmes së Shqipërisë.

SHQIPËRIA

RISHIKIM I SISTEMIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

I. HYRJE

1. Programi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri ishte pjesërisht i trashëguar nga e kaluara dhe ishte i hartuar në mënyrë të tillë që ofronte sigurim gjithëpërfshirës për vjetërsi, paaftësi, vdekje, sëmundje afatshkurtra, shëndet të ligisht dhe papunësi në bazë të kontributit të bërë si nga i punësuar, ashtu edhe nga punëdhënësi. Ky lloj sistemi funksionon relativisht mirë në kontekstin e një pjesëmarrjeje të lartë të krahut të punës në sektorin formal. Megjithatë, pas tranzicionit, pjesëmarrja në tregjet zyrtare të punës në Shqipëri ka rënë ndjeshëm, duke ngritur pikëpyetje nëse kuadri i sigurimeve shoqërore është faktikisht struktura e duhur për sigurimin e përfitimeve të mbrojtjes sociale në të ardhmen për të gjithë popullsinë. Gjithashtu, programi përfshin një shkallë relativisht të lartë kontributive, në fillim e përcaktuar tek 41.9 përqind të pagës, nga e cila 0.8 përqind ishte për të mbuluar sëmundjet, 2.3 përqind ishte për leje lindjeje, 29.9 përqind për pensionet, 3.4 përqind për sigurimet shëndetësore, 0.5 përqind për dëmtime profesionale dhe 5 përqind ishte sigurim (pagesë) për papunësinë. Ligji i ri i sapo miratuar e ka ulur totalin e kontributit me 9 pikë, duke e ulur pagesën për papunësinë në 2 përqind dhe duke ulur me 6 pikë përqindjeje takse për pensionet.

2. Ky rishikim i sistemit të sigurimeve shoqërore do të fokusohet kryesisht tek pensionet, duke patur parasysh faktin që ato përfaqësojnë komponentin më të madh të taksës së borderosë dhe zërin më të madh të shpenzimeve. Si fondi për sëmundjet, ashtu edhe ai për lejen e lindjes shpesh gjeneron teprica të vogla që më pas përdoren për subvencionimin e pensioneve. Në të kalurën edhe pagesa për papunësinë gjithashtu siguronte teprica dhe të ardhurat prej saj kaloheshin tek Insituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH). Me uljen e kontributeve për papunësinë mund të nisin të shfaqen vrima më të mëdha në llogaritë e ISSH-së. Megjithatë, pjesa më e madhe e diskutimeve në lidhje me rolin e sigurimeve shoqërore krahasuar me format e tjera të ofrimit të mbrojtjes sociale do të jetë relevante për të gjitha degët e sigurimeve shoqërore. Ky rishikim do të bazohet në një masë të madhe në rishikimin e përfunduar kohët e fundit për sektorin e shëndetësisë (shkurt 2006) për një diskutim specifik të çështjeve të sektorit të shëndetësisë.


3. Rishikimi ka këtë strukturë: seksionet 2 dhe 3 marrin në diskutim karakteristikat demografike të sistemit shqiptar të pensioneve dhe parametrat e tij; seksioni 4 parashtron parashikimet e politikës aktuale, ndërsa seksioni 5 përshkruan opsionet e reformave të politikave; seksionet 6-8 hedhin një vështrim të shkurtër mbi implikimet e reformës së politikave të pensioneve në degët e tjera të sigurimeve shoqërore dhe seksioni 9 bën përmbylljen.

II. KUSHTET DEMOGRAFIKE DHE ATO TË TREGUT TË PUNËS

4. Si kudo tjetër në Evropën Qendrore, 100 përqindshi tradicional i pjesëmarrjes në krahun e punës si për meshkujt dhe për femrat ka çuar në një përqindje të lartë të moshuarish që marrin pensione, ndërsa rritja post-tranzicionale e shkallës së informalitetit ka çuar në një numër të vogël kontribuesish midis popullsisë në moshë pune. Kjo mungesë balance midis kontribuesve dhe përfituesve ka çuar tipikisht në probleme fiskale në lidhje me financimin e përfitimeve sipas një sistemi ku paguhen pensionet me të adhurat e vitit korrent (*në anglisht- pay as you go system*) dhe ku të ardhurat nga kontributet e kontribuesve aktuale përdoren për të financuar përfitimet për të moshuarit aktualë.

5. Bazuar thjesht dhe vetëm tek treguesit demografikë, Shqipëria është një nga vendet me popullësi të re në rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore (ECA) të Bankës Botërore, siç tregohet në Figurën 2.1, ku bëhet një krahasim i përqindjes së popullsisë mbi 65 vjeç për një numër ekonomish në tranzicion. Në Shqipëri vetëm 8.3 përqind e popullsisë është në moshën mbi 65 vjeçare, pothuajse një e treta më pak se mesatarja e përgjithshme e ECA-s prej 12.1 përqind. Bullgaria, Latvia dhe Kroacia kanë afërsisht 17 përqind të popullsisë së tyre në moshën mbi 65 vjeç.

Figura 2.1: Përqindja e popullsisë mbi 65 vjeç midis vendeve të ECA-s



6. Tabela 2.1 parashtron shumë nga përmbledhjet tipike statistikore për sistemin shqiptar të pensioneve. Sistemi shqiptar i sigurimeve shoqërore ka skema tepër të veçanta/të ndara për sektorët urbanë dhe ruralë dhe statistikat jepen sipas sektorëve. Tabela 2.1 tregon një ndarje pothuajse të barabartë të kontribuesve midis sektorit rural dhe atij urban. Megjithatë, nga pikëpamja e përfituesve ka një pabarazi të thellë midis të dy sektorëve, ku përfituesit urbanë i tejkalojnë përfituesit ruralë në raportin pothuajse 2 me 1. Sektori rural në Shqipëri nuk ka qenë i mbuluar nga asnjë formë sigurimesh shoqërore deri në vitin 1972. Duke qenë se për të përfituar një pension të plotë kërkohen 35 vite kontribut, shumë pak të punësuar ruralë kualifikohen aktualisht për të përfituar pension të plotë dhe ata që dalin në pension shpesh marrin vetëm pension të pjesshëm. Diferenca midis sektorëve reflektohet në koeficientët/raportet e varësisë së sistemit, të cilat janë shumë më të larta për sektorin urban me më shumë kontribues sesa në

sektorin rural, por në të dyja rastet janë shumë më të larta sesa raporti/koefficienti i varësisë së popullsisë.

Tabela 2.1: Tregues demografikë dhe financiarë të sistemit shqiptar të pensioneve

Treguesit	Urban	Rural	TOTAL
Numri i kontribuesve (total)	320,000	340,000	660,000
<i>burra</i>	183,500	236,600	
<i>gra</i>	136,500	103,400	
Numri i përfituesve	367,900	187,300²	555,300
Pension pleqërie	286,400	160,000	446,400
<i>Burra</i>	150,700	77,100	
<i>Gra</i>	135,700	82,900	
Paaftësie	27,600 ¹	3,600	31,200
<i>Burra</i>	17,200	2,300	
<i>Gra</i>	10,500	1,300	
Për personat e mbetur të ve	42,100	17,500	59,600
<i>Burra</i>	700	3,700	
<i>Gra</i>	41,400	13,800	
Jetimë	11,800	6,300	18,000
Koeficienti i varësisë së popullsisë në moshë të thyer	115.0%	55.0%	84.1% 19.3%
Shpenzimet në milionë lek	30,900	5,800	36,800
<i>Pension pleqërie</i>	26,100	5,300	31,400
<i>Paaftësie</i>	2,300	100	2,400
<i>Për personat e mbetur të ve</i>	1,900	200	2,100
<i>Jetimët</i>	700	200	900
Mbulesa nga sistemi (kontribuesit/Total Pop 15 vjeç-deri në moshën e daljes në pension)	16.6%	17.6%	34.1%
mbulesa për pensionistët (Pensionistët/Total i moshës së daljes në pension +)	76.9%	41.5%	118.3%
Të ardhurat si % e GDP-së në vitin 2005			4.93%
Shpenzimet si % e GDP-s në vitin 2005			5.04%


7. Faktikisht, një vështrim mbi koeficientët e varësisë së sistemit, që japin një krahasim të numrit total të përfituesve nga sistemi i pensioneve, me numrin e përgjithshëm të kontribuesve tregon që Shqipëria, siç ilustron në figurën 2.2., ka raportin më të lartë në rajon dhe një ndër më të lartët në botë të koeficientëve të varësisë së sistemit në raport me koeficientin e varësisë së popullsisë, që është raporti i popullsisë së moshuar të një vendi pjesëtuar me numrin e popullsisë në moshë pune. Siç parashtrohet edhe më lart, Shqipëria ka një numër relativisht të vogël të popullsisë së moshuar, me një raport/koefficient të varësisë së popullsisë prej vetëm 19.3

¹ Treguesit për moshën dhe gjininë për përfituesit, me përjashtim të atyre për moshën e thyer janë bazuar në rezultatet e një modeli të administruara nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore. Në rastin e moshës së thyer, përcaktimi bëhet sipas të dhënave për moshën aktuale dhe gjininë të siguruara nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore.

² Ndërsa numri gjithsej i përfituesve për sektorin rural është dhënë nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore, nuk janë bërë përcaktime sipas gjinisës dhe moshës. Ky përcaktim për gjininë dhe moshën u supozua të ndiqte atë të përdorur në sektorin urban për të cilin kishte një përcaktim të përafërt.

individësh mbi moshën e pensionit prej 61 vjeç për burrat dhe 56 për gratë në vitin 2004 për 100 individë në moshë pune, e matur që nga moshë 15 vjeçare deri në moshën përkatëse të daljes në pension. Megjithatë, siç ilustron Figura 2.2, koeficienti i varësisë së sistemit është i stërmadh, duke aritur në nivelin mbi 84 përfitues për 100 kontribues. Në shumë vende të rajonit të ECA-s, koeficientët e varësisë së sistemit janë të larta duke qenë se ka shumë individë nën moshën e pensionit që përfitojnë pagesa paaftësie dhe pagesa të tjera. Ky nuk është rasti i Shqipërisë, ku shifrat e përfituesve të pagesës së paaftësisë dhe të pagesës për fëmijët e mbetur jetimë janë mbajtur relativisht të ulta përmes aplikimit të masave të forta të politikave të duhura dhe përmes zbatimit të këtyre masave. Një përfitim i veçantë jokontributiv për paaftësinë, që siguron pagesa më të larta për individët që kualifikohen për këto pagesa dhe që administrohet nga një agjenci e veçantë, si edhe Ndihma Ekonomike, që garanton përfitime për individët që kualifikohen për të përfituar nga ky program, e kanë lehtësuar Institutin e Sigurimeve Shoqërore nga një pjesë e barrës së trysnive sociale me të cilat janë përballur vende të tjera për të zgjeruar kriteret për t'u ofruar përfitime një numri më të madh individësh.

Figura 2.2: Koeficientët e varësisë së sistemit në Shqipëri krahasuar me pjesën tjetër të rajonit të ECA-s



8. Nga ana tjetër, numri i përfituesve të moshuar duket tepër i lartë. Nga 372,000 persona që kanë mbushur moshën e daljes në pension, mbi 440,000 marrin pensione të një lloji të caktuar. Diskutimet me Institutin e Sigurimeve Shoqërore sugjerojnë një shpjegim të situatës. Familjarët e një personi që vdes kanë përgjegjësinë për të informuar ISSH-në që pensionisti ka vdekur dhe që pensioni duhet të mos vazhdojë me. Deri momentin që të bëhet ky njoftim, ISSH-ja vazhdon të paguajë pensionin. Mospërputhja midis numrit të të moshuarve në statistikat e popullsisë dhe numrit të individëve që përfitojnë pension pleqërie sugjeron që në shumë raste familjet nuk e informojnë ISSH-në dhe vazhdojnë të marrin pagesa. Ky shpjegim duket në veçanti i mundshëm duke patur parasysh që mospërputhjet midis numrit të personave në popullsi në përgjithësi dhe numrit të pensionistëve në atë moshë bëhen edhe më të thelluara në moshat më të thyera. Për më tepër, rezultatet paraprake të vlerësimit të nivelit të varfërisë tregojnë se pensionet e pleqërisë kanë një impakt më të madh në uljen e varfërisë sesa programi i Ndihmës Ekonomike. Ky rezultat i veçantë nuk është replikuar në vende të tjera të rajonit dhe në veçanti jo në një vend me popullsi të re si Shqipëria, ku mendohet se numri i familjeve që përfitojnë nga të ardhurat e pensioneve duhet të jetë më i vogël. Një shpjegim i mundshëm sërish mund të ishte

që familjet e varfra me një të afërm të moshuar i cili vdes vazhdojnë të marrin pensionin, duke i dhënë pensionit të pleqërisë një rol shumë më të gjerë në uljen e varfërisë nga ç'do të kishte patur përndryshe po të kishte qenë i kufizuar vetëm për të moshuarit.

9. Nga pikëpamja e kontributeve, historia në Shqipëri është pothuajse e njejtë me ekonomitë e tjera në tranzicion. Pas tranzicionit, ndërmarrjet e sektorit publik u reduktuan në numër dhe u privatizuan. Ekonomia e re private u bazua së tepërmi në tregun joformal të punës, në vend që të bazohej në tregun më të shtrenjtë dhe më të rregulluar formal të punës. Rrjedhimisht, emëruesi në formulën e koeficientit të varësisë, d.m.th. numri i kontribuesve në sistemin e pensioneve ra ndjeshëm. Raporti i kontribuesve me numrin e personave të punësuar aktualisht qëndron në 46 përqind, që është mesatarja për rajonin e ECA-s, si edhe për një vend me nivelin e të ardhurave të Shqipërisë kudo në botë. Megjithatë, duhet theksuar se gjysma e këtyre kontribuesve vijnë nga sektori rural, për të cilët shteti jep 85 përqind të kontributeve. Rrjedhimisht dhe si të tillë ata mbeten kontribues kryesisht si emër, më shumë sesa në thelb. Po të hiqen këta kontribues, përqindja e koeficientit të mbulesës së kontribuesve përfaqëson një numër shumë më të vogël të të punësuarve, që e vendos Shqipërinë poshtë mesatares të ECA-s përse i përket mbulesës nga sistemi.

10. Nga pikëpamja financiare, qeveria po shpenzon 5.04 përqind të GDP-së si shpenzime për sigurimet shoqërore, nga të cilat 85 përqind janë pagesat aktuale për pensionet. Megjithatë, edhe shifra prej 85 përqind nuk e shpreh sa duhet shumën e madhe që shkon si shpenzime për pensionet, duke qenë se nga shpenzimet që mbeten, një 13 përqindsh mbulon kostot administrative dhe kompensime shtesë që u jepen për disa ose të gjithë pensionistët. Nga pikëpamja e të ardhurave, Instituti i Sigurimeve Shoqërore grumbullon të ardhura që janë 4.93 përqind e GDP-së, nga të cilat 78 përqind janë të ardhura nga kontributet. Megjithatë, mbi dy të tretat e atyre të ardhurave vijnë nga vetë shteti në formën e kontributeve të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Një 22 përqindsh tjetër i të ardhurave vjen nga transfertat shtetërore për Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Në total, shteti siguron 78 përqind të të ardhurave që shkojnë tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

III. PËRSHKRIM I PARAMETRAVE TË SISTEMIT SHQIPTAR TË PENSIONEVE

11. Ndërsa karakteristikat demografike dhe ato të tregut të punës të sistemit të pensioneve në Shqipëri nuk flasin për një qendrueshmëri afatgjatë financiare, disa elementë të modelit të politikave kanë tendencën t'i thellojnë edhe më këto tendenca. Një element shumë i rëndësishëm i modelit janë sistemet e veçanta që aplikohen për sektorin urban dhe atë rural. Tabela 3.1 parashtron parametrat kryesorë të sistemit të sektorit urban.

Tabela 3.1: Parametrat e skemës së pensioneve të sektorit urban në Shqipëri

Parametrat e sistemit shqiptar të pensioneve	
Përqindjet e kontributit	29.9 përqind për pensionet, nga të cilat 71.2 përqind paguhet nga punëdhënësi dhe pjesa tjetër nga i punësuari
Mosha e daljes në pension	65 vjeç burra/60 vjeç gratë, ku do të zbatohet në mënyrë graduale modeli 35 vjet pune deri në vitin 2012 në dallin nga 60vjeç/55 vjeç që ka qenë për shumicën e profesioneve në vitin 2001; Mosha 50 vjeç për gratë me 6 fëmijë dhe 30 vjet kontribut në sigurimet shoqërore
Përqindja e përfitimit	Pensioni bazë + 1 përqind në vit të mesatares jetike të rivlerësuar sipas rritjes së kontributeve mesatare; Në varësi të limiteve të shtrënguara të pensionit maksimal; pensioni nuk mund të jetë më i lartë se dyfishi i shumës bazë ose 75 përqind e pagës mesatare neto për 3 vjet pandërprerje gjatë 10 vjetëve të fundit të punësimit, cilado shifër të jetë më e ulta; 0.34 përqind në muaj shtesë për shtyrjen e moshës së daljes në pension përtej moshës së caktuar për daljen në pension; 0.6 përqind reduktim në muaj për dalje të parakohshme në pension, deri 3 vjet përpara afatit; Pension i pjesshëm i parakohshëm për personat në moshë pensioni me një periudhë minimale kontributive prej 15 vjetësh
Indeksi i pensioneve pas daljes në pension	Indeksohet sipas legjislacionit në përputhje me ndryshimet e çmimeve, por në realitet Këshilli i Ministrave merr vendime ad.hoc, sipas disponibilitetit të të ardhurave dhe synimit të arritjes së standardit minimal jetik
Pension për paaftësi	Përfitohet vetëm në rast se ka patur kontribute për gjysmën e periudhës nga mosha 20 vjeçare deri në moshën e paaftësisë; Pensioni i barabartë me shumën bazë + 1 përqind për çdo vit të mesatares jetike të rivlerësuar sipas rritjes së kontributeve mesatare; Pensioni maksimal është ose dyfishi i shumës bazë ose 80 përqind i pagës së fundit
Pension për personat e mbetur të ve	E ve në moshën 50 vjeçare ose në rast se ka nën kujdes një fëmijë ose një person me paaftësi; i ve në moshën 60 vjeçare ose në rast se kujdeset për një fëmijë ose person me paaftësi; jetim deri në moshën 25 vjeçare në rast se shkon në shkollë ose përndryshe deri në moshën 18 otherwise ose në rast se është me paaftësi; prindër që jetonin në shtëpinë e të ndjerit për së paku 1 vit dhe janë në moshën 65 vjeçare ose janë me paaftësi; Pensioni i barabartë me 50 përqind të pensionit të të ndjerit për personin e mbetur i vi/e ve dhe 25 përqind për jetimët ose personat të tjerë në ngarkim, në varësi të maksimumit 100 përqind

12. Kontributet në Shqipëri dikur mbledheshin nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Në vitin 2006, përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve për të gjithë të punësuarit urbanë iu kalua autoriteteve tatimore, të cilët më pas i kalojnë të ardhurat tek Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Instituti i Sigurimeve Shoqërore vazhdon të mbledhë të ardhurat nga kontributet e të punësuarve ruralë.

13. Përqindjet e kontributeve në Shqipëri janë të larta në krahasim me mesataret e këtyre kontributeve për vendet e OECD-së. Figura 3.1 tregon përqindjet e kontributit për Shqipërinë, vetëm për pensionet, në krahasim me përqindjet në vendet e OECD-së. Me përjashtim të Italisë dhe Portugalisë, që kanë përqindje pak më të larta, Shqipëria ka përqindjet më të larta të kontributit në këtë grup vendesh. Niveli i lartë në rastin e Shqipërisë është veçanërisht sinjifikativ duke patur parasysh faktin që përqindjet e kontributit zakonisht rriten me mplakjen e popullsisë së atij vendi. Shqipëria ka këto përqindje tejet të larta me një popullsi ende të re. Qeveria shqiptare kohët e fundit ka miratur një ligj për uljen graduale të këtyre përqindjeve, por edhe pas kësaj uljeje ato do të jenë të larta për një vend me moshë kaq të re. Figura 3.2 tregon përqindjet e kontributit në Shqipëri në krahasim me vendet e Evropës Qendrore. Përqindjet për Shqipërinë janë ende të larta, por jo shumë më të ndryshme nga përqindjet e tjera për Evropën Qendrore duke qenë se secili prej këtyre vendeve është përballur me të njëjtën rënie të numrit të kontribuesve si Shqipëria.

Figura 3.1: Përqindjet e kontributeve për pensionet në Shqipëri në krahasim me vendet e OECD-së






Figura 3.2: Përqindjet e kontributeve në sistemin shqiptar të pensioneve në krahasim me vendet e tjera në tranzicion



14. Moshë e daljes në pension në Shqipëri është ende relativisht e ulët. Në fillim, moshë e daljes në pension për shumicën e popullsisë ishte 60 vjeç për burrat dhe 55 për gratë dhe një moshë më e ulët për kategori të veçanta tek 50 vjeç për burrat dhe 45 për gratë. Këto kategori të veçanta po hiqen gradualisht, ndërsa moshë e daljes në pension është rritur në 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë, por këto moshë do të arrihen nga shumica e të punësuarve vetëm në vitin 2011 dhe ndoshta edhe më vonë për kategori të veçanta të punësuarish. Moshat e daljes në pension po rriten me 6 muaj në vit, kur moshë e daljes në pension në vitin 2004, siç tregohet në Figurën 3.3, ishte 61 vjeç për burrat dhe 56 për gratë. Siç ilustron në Tabelën 3.1, grave me 6 ose më shumë fëmijë ende u lejohet të dalin në pension në moshën 50 vjeçare, po të kenë 30 vjet punë. Në të gjitha rastet, pensioni i plotë jepet me 34 vite pune në fillim të vitit 2004, ndërsa tani duhet të kesh 35 vite pune për ta përfituar një pension të plotë. Pensionet e parakohshme japin vetëm më 15 vite pune.

Figura 3.3: Moshat e daljes në pension në Shqipëri në krahasim me vendet e OECD-së në vitin 2004




15. Formula e përfitimit në sistemin e pensioneve nis relativisht mirë. Formula është pensioni bazë, që është e njejta gjë me pensionin minimal, plus 1 përqind për çdo vit pune. Pensioni bazë caktohet nga Këshilli i Ministrave. Në vitin 2005 ishte afërsisht 38 përqind e pagës bruto të mbuluar për pensionistët e rinj. Teorikisht, kjo mund të siguronte koeficientë zëvendësimi tepër bujarë me 35 vite pune, në nivelin 73 përqind e pagës për një person me një pagë mesatare, në krahasim me shifrën prej 40 përqind për 30 vjet pune të rekomanduar nga ILO-ja. Megjithatë, pensioni i plotë mesatar në sektorin urban arrin vetëm në 40% të pagës bruto të mbuluar, që nuk është substancialisht më i lartë sesa pensioni bazë. Ka disa faktorë që e shpjegojnë këtë mospërputhje. E para, ekzistojnë disa limite tepër strikte për pensionin maksimal. Ky pension është i kufizuar tek dyfishi i pensionit bazë, gjë që sugjeron që individët me të ardhura të larta që mund të sigurojnë të ardhura mbi pagën mesatare do ta arrijnë limitin shumë shpejt. Faktikisht, edhe në rast se pensioni maksimal do të ishte i indeksuar për pagën, gjë që ligjërisht nuk ndodh, individët që marrin dyfishin e pagës mesatare do ta arrijnë maksimumin vetëm pas 25 vjetësh punë dhe individët që fitojnë trefishin e pagës mesatare do të arrijnë vetë me 18 vjet punë. Këto limite do të arriheshin shumë më shpejt sipas maksimumit të indeksuar për çmimin që përcaktohet në legjislacion. Së dyti, pensioni është gjithashtu i kufizuar në rast se

një individ arrin 75 përqind të mesatares neto të pagës më të lartë të 3 viteve të njëpasnjëshëm në 10 vitet e fundit. Ndonëse në ligj sugjerohet që pagat në të kalurën duhet të rivlerësohen sipas rritjes së kontributeve çdo vit, praktikisht limitet janë aplikuar për mesataren e pagave nominale, duke i kufizuar edhe më pensionet. Për më tepër, pensioni minimal, që me ligj kërkohet të indeksohet sipas inflacionit është rritur shumë më shpejt sesa inflacioni në një përpjekje për të barazuar pensionin minimal me standardin minimal të jetesës, si edhe është rritur më shpejt sesa rritjet e pensioneve mbi minimalen. Rrjedhimisht, shumë individë e gjejnë veten duke përfituar një pension minimal, pavarësisht nga shumat që kanë kontribuar.

16. Figura 3.4 tregon nivelin e brendshëm të kthimit (në anglisht- *internal rate of return*) që sigurohet nga struktura aktuale e përfitimeve për individët me të ardhura të larta, të mesme dhe të ulta.³ Siç mund të shihet qartë, individët me të ardhura të larta kanë një nivel relativisht të ulët kthimi krahasimisht me individët me të ardhura të ulta që përfitojnë si nga pensioni bazë rishpërndarës dhe nga aksesit në pensionin minimal. Gratë kanë nivele më të larta kthimi se burrat sepse kanë jetëgjatësi më të madhe dhe marrin pension për një kohë më të gjatë sesa burrat për të njëjtin nivel page dhe të njëjtin nivel kontributi.

Figura 3.4: Niveli i brendshëm i kthimit për Individët me Nivele të ndryshme të ardhurash në sistemin urban të pensioneve




17. Figura 3.5 ilustron të njëjtat fakte, por nga një perspektivë e ndryshme, duke krahasuar pensionin që merr një individ, me pagën e tij/saj të fundit. Edhe këtu, individët me të ardhura të larta marrin pensione që vlerësohen tek 25-28 përqind e pagës së tyre të fundit. Këto pensione do të paguheshin për afërsisht 20 vjet. Për të marrë këto pensione, këta individë kanë paguar 29.9 përqind të pagës për 40 vjet. Sigurisht që sistemi i pensioneve nuk ofron shumë për këta të punësuar. Nga pikëpamja e rishpërndarjes, pensionet në mënyrë të qartë rishpërndahen drejt të punësuarve me të ardhura më të ulta.

18. Nga pikëpamja e stimujve, në rast se shumica e personave do të përfitojnë pensionin minimal pavarësisht nga sa deklarojnë në paga apo do të përfitojnë vlera të ulta për kontributet e pensioneve të tyre, sigurisht që ata do të zgjedhin të deklarojnë pagën minimale. Kjo është

³ Karakteristikat e sakta të individëve të supozuar përshkruhen në Aneks.

pikërisht ajo që po ndodh në sektorin privat. Ndërsa sektori publik punëson pothuajse 20 përqind më pak individë sesa sektori privat jofermer, entet shtetërore kontribuojnë mbi dyfishin e të ardhurave që kontribuojnë kompanitë private. Ndërsa sektori privat supozohet të ofrojë paga më të larta se sektori publik, mbi 50 përqind e të punësuarve në sektorin privat deklarojnë pagën minimale, ndërsa në sektorin publik vetëm 1 përqind e të punësuarve deklarojnë pagën minimale. Nga pikëpamja e pensioneve, qysh kur pensionet minimale u rritën me shpejt se pensionet e tjera, mbi 68 përqind e pensionistëve në sektorin urban marrin pensionin minimal ose më pak, ndërsa vetëm 9 përqind e pensionistëve në sektorin rural marrin pensione mbi nivelin minimal. Për këtë vit është parashikuar një ri-llogaritje e pensioneve, i cili do të bëjë rilogaritjen e pagës mesatare 3 vjeçare, duke rivlerësuar pagat e mëparshme sipas rritjes së kontributeve që paguhen për sigurimet shoqërore, e cila përpiket të vërë në vend disa nga këto shmangie/devijacione. Megjithatë, ende do të ekzistojnë stimuj për të deklaruar paga sa më të ulta dhe për një numër më të vogël vitesh duke qenë se paga maksimale subjekt i kontributeve është pesëfishi i pagës minimale, ndërsa pensioni maksimal është vetëm dyfishi i pensionit minimal.

Figura 3.5: Pensionet e marra si përqindje e pagës së fundit personale për individë me nivele të ndryshme të ardhurash



19. Ka edhe pengesa/barriera të tjera që lidhen me shtyrjen e moshës së daljes në pension. Shpërblimi për shtyrjen e moshës së daljes në pension është sa gjysma e gjobës që vendosët për individët të cilët zgjedhin të dalin në pension deri në 3 vjet përpara mbushjes së moshës për të dalë në pension. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh që shumica e personave që plotësojnë vitet e punës pa shkëputje do ta kenë arritur tashmë pensionin maksimal. Kështu, nga shtyrja ata nuk fitojnë asgjë. Nga ana tjetër, shumë individë, sidomos ata me të ardhura të larta do ta arrijnë pensionin maksimal më herët nga ç' do të kërkonte një karrierë e plotë vitesh pune pa shkëputje, apo do të kenë plotësuar 35 vjet punë përpara se të arrijnë moshën e daljes në pension. Për këta individë që tashmë arrijnë limitet e pensionit maksimal, dalja më herët në pension nuk sjell ndonjë ndikim negativ duke qenë se pensioni nuk ndryshon. Këto limite strikte për pagesat e pensioneve mund të kenë shërbyer për mbajtjen nën kontroll të shpenzimeve për pensionet, por ato gjithashtu u japin individëve stimulim për të dalë në pension sa më herët të jetë e mundur.

20. Në lidhje me pagesat për paaftësi, kushtet për përfitim dhe kualifikim janë sipas standardeve të duhura. Shqipëria ka qenë shumë më e sukseshme në mbajtjen brenda kufirit të

numrit të pensionistëve me paaftësi sesa fqinjët e saj dhe ka shmangur përdorimin e sistemit të pensionit për paaftësi si një mjet për zbutjen e tranzicioneve në tregun e punës. Nga ana tjetër, në Shqipëria ekziston një Sektor për Individët me Paaftësi në Departamentin e Shërbimeve Sociale, që ofron një pagesë më të lartë asistence sociale për personat që hyjnë në kategorinë e të paaftëve, nga ajo që ofrohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Individët që marrin pagesë paaftësie nga ISSH-ja nuk përfitojnë pagesa nga Shërbimet Sociale, kështu që edhe ata person që mund tu takojë pension paaftësie nga ISSH-ja shpesh zgjedhin të mos e marrin. Një çështje që del nga brenda sistemit të pensioneve është që pensioni maksimal për pensionistët me paaftësi është 80 përqind e pagës mesatare, që është e ndryshme nga limiti 75 përqind për pensionistët që përfitojnë pension pleqërie. Pastaj, nga çdo pikëpamje tjetër, formulat e pensionit janë identike. Nuk është i qartë fakti përse në rastin e pensionistëve me paaftësi aplikohet limiti më i lartë. Personat me paaftësi të pjesshme përfitojnë pensione për këtë lloj paaftësie.

21. Pensionet për personat e mbetur të ve mund të anojnë pak nga ana e disfavorshme, ku këta të fundit marrin gjysmën e pensionit që ka vdekur. Një çifti nuk i nevojitet dyfishi i të ardhurave të një personi beqar për të jetuar po me ato lehtësi. Një person i ve që jeton vetëm nuk mund të jetojë po aq mirë me gjysmat e të ardhurave të çiftit, sikundërse jetonte çifti me pension të plotë. Në rast se ka shumë persona të ve që jetojnë vetëm, përfitimet janë tipikisht 60-70 përqind e pensionit të personit që ka vdekur. Në rast se personat e mbetur të ve jetojnë me anëtarë të tjerë të familjes, niveli është i përshtatshëm.

22. Shumica e parametrave të sistemit rural janë identike me ato të sistemit urban. Një përjashtim shumë të madh këtu bën përqindja e kontributeve. Të punësuarit ruralë vlerësohen me kontribute fikse të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, një shumë për të punësuarit në fushë dhe një shumë edhe më e ulët për të punësuarit në zonat malore. Qeveria pastaj bën llogaritjen e kontributit të plotë që do të duhej të kërkohej mbi bazën e pagës minimale urbane dhe paguan diferencën midis kësaj dhe kontributit fiks që paguhet nga të punësuarit ruralë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore. Vitet e fundit, kontributi i shtetit ka arritur në afro 85% të totalit, duke e bërë këtë sistem kontributiv kryesisht si emër dhe jo si përmbajtje.

23. Ndërsa sistemi i përfitimeve për pensionistët në zonat rurale është i strukturuar në mënyrë identike me atë të të punësuarve urbanë, niveli i përfitimit minimal dhe maksimal përcaktohet veçmas. Ka një përqindje më të lartë të pensionistëve të zonave rurale nga ata të zonave urbane që marrin pensionin minimal. Përfitimet jepen mbi bazën e pagës minimale urbane ose më të larta në rast se kontributet janë paguar për paga më të larta, ndërsa kontributet aktuale nga të punësuarit janë shumë më të ulta. Pensionet që paguhen nga sistemi rural janë aktualisht më të ulta sesa në sistemin urban, por do të barazohen me pensionet urbane afër vitit 2012. Për të arritur këtë barazi, qeveria i ka ritur çdo vit pensionet rurale shumë më shumë nga ato urbane. Në vitin 2006, pensionet në zonat rurale u ritën me 20 përqind, ndërsa pensionet urbane me vetëm 5 përqind. Duke qenë se sistemi rural i pensioneve hyri në fuqi vetëm në vitin 1972, aktualisht asnjë i punësuar rural nuk përfiton pension të plotë, duke qenë se për një gjë të tillë kërkohej 35 vjet punë. Pensionet e parakohshme për një numër më të vogël vitesh pune janë pjesërisht shkak i niveleve të ulta të pensioneve.

24. Përveç pensioneve, pensionistët gjithashtu marrin tri lloje kompensimesh shtesë, që janë kompensimi për energjinë elektrike, kompensimi për bukën dhe kompensimi për anëtarët e

familjes në ngarkim. Paratë për financimin e këtyre kompensimeve shtesë vijnë direkt nga buxheti i shtetit. Mesatarisht ato e risin kompensimin mujor për pensionin e pleqërisë me 6-7 përqind. Duke qenë se pagesat janë uniforme, personat e mbetur të ve/jetimë që marrin pensione të vogla përfitojnë një rritje prej 12 përqind nga këto kompensime shtesë.

IV. PARASHIKIME PËR SISTEMIN AKTUAL TË PENSIONEVE, 2004-2075

25. Ky seksion paraqet rezultatet e parashikimeve për pensionet në Shqipëri, si për sistemin urban, ashtu edhe për atë rural. Parashikimet janë formuluar sipas modelit PROST të Bankës Botërore, që është përdorur për parashikimet për sistemet e pensioneve në mbi 80 vende. Modeli bën parashikime për popullsinë, numrin e kontribuesve dhe përfituesëve të sistemit, kontributet ose përfitimet e tyre vjetore përkatësisht dhe rezultatit e përgjithshëm financiar të sistemit. Ky model ka marrë të dhëna të vitit 2004 të nxjerra nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe me anë të tyre bën parashikimet për të ardhmen. Periudhat për parashikimin arrijnë deri në vitin 2075, me qëllim që të vlerësohet nëse mund të mbahen në të ardhmen premtimet që u bëhen personave që hyjnë sot në krahun e ri të punës.

26. Parashikimet bazohen kryesisht në supozime. Tabela 4.1. jep një përmbledhje të supozimeve të sjelljeve demografike dhe ekonomike.

Tabela 4.1: Supozime për pjellorinë dhe sjelljen që janë përdorur në parashikimet


Supozime	2004	2005	2006	2010	2025	2050	2075
% totale e pjellorisë	228.9%	227.2%	225.5%	218.8%	209.7%	208.6%	207.5%
Pritshmëria jetike në lindje, meshkuj	71.5	71.9	72.3	73.9	76.3	77.5	79.0
Pritshmëria jetike në lindje, femra	76.3	76.6	77.0	78.5	81.0	83.0	85.2
Mbulesa e kontribuesve	Janë ruajtur % e vitit 2004 si përqindje për secilin grup moshë specifike të popullsisë, por duke përfshirë rritjen e moshës së daljes në pension						
Vitet e punës	Janë ruajtur gjatë gjithë kohës përqindjet e vitit 2004, por është përfshirë rritja e moshës së daljes në pension						

27. Shqipëria është në pozicionin e lakmueshëm të të qenit një vend me moshë të re dhe ku numri i popullsisë parashikohet të rritet gjatë gjithë periudhës së simulimit në krahasim me shumë nga fqinjët e saj, të cilët parashikojnë rënie drastike të numrit përkatës të popullsisë. Sigurisht që ritmet e rritjes së popullsisë do të ngadalësohen, por gjithësesi do të vijojnë të mbeten pozitive. Megjithatë, përqindja e popullsisë mbi moshën e daljes në pension do të rritet ndjeshëm nga 11.6 përqind që është aktualisht në 25 përqind, që përfaqësojnë një të katërtën e popullsisë. Raporti i varësisë së popullsisë në moshë të thyer, që është përkufizuar si raporti i përqindjes së popullsisë që e ka kaluar moshën e daljes në pension me përqindjen e popullsisë në moshë punë, do të rritet ndjeshëm, siç tregohet në Figurën 4.1. Rënia fillestare është plotësisht si rrjedhojë e rritjes së moshës së daljes në pension nga 61 vjeç për burrat dhe 56 për gratë në 65 për burrat dhe 60 për gratë. Pas zbatimit të plotë të ndryshimit në moshën e daljes në pension, koeficienti i varësisë së moshës së thyer vjen duke u rritur ndjeshëm si pasojë e rritjes së numrit të të moshuarve, shoqëruar me një rritje më të ngadaltë të popullsisë në moshë pune.

28. Koeficientët e varësisë së sistemit, numri i përgjithshëm i përfituesve për 100 kontribues pasqyrojnë koeficientët e varësisë së moshës së thyer. Si në sistemin rural ashtu edhe në atë urban, koeficientët e varësisë së sistemit fillimisht bien si reagim ndaj rritjes së moshës së daljes në pension. Me zbatimin e plotë të rritjes së moshës së daljes në pension, përqindjet fillojnë të rriten përsëri. Në periudhën afatgjatë, në sistemin urban përqindjet nisin të bien pak pas vitit 2050. Aktualisht, të gjithë të moshuarit përfitojnë pensione pleqërie. Megjithatë, duke qenë se

një përqindje shumë më e ulët e popullsisë punonjëse kontribuon në sistem, numri i të moshuarve që kanë të drejtë të përfitojnë nga sistemi i pensioneve do të fillojë të bjerë kur kontribuesit aktualë, individët që nuk e kanë mbushur numrin e plotë të viteve të punës pas tranzicionit, fillojnë të dalin në pension. Për më tepër, sipas këtij modeli parashikohet që shifra mbi 100 përqind e të moshuarve që marrin pension, që ekziston aktualisht në të dhënat e sotme, gradualisht do të bjerë në nivelet normale momentin që këta individë të mos jenë më pjesë e sistemit. Koeficientët e varësisë së sistemit si për sistemin urban ashtu edhe për atë rural, veçmas dhe së bashku paraqiten në Figurën 4.2. Megjithatë, Figura 4.2 ka vend për një paralajmërim. Në model parashikohet që kontribuesit të vazhdojnë të paguajnë për 35 vjet të plota siç kanë bërë në të kalurën. Kjo ndoshta do të jetë e vlefshme për të punësuarit në sektorin publik, të cilët përbëjnë një numër të madh kontribuesish. Por diskutimi mbi stimujt nga seksioni i mëparshëm sugjeron që janë të shumtë personat të cilëve u mungon pothuajse fare stimuli për të kontribuar për vite të plota pune dhe një gjë e tillë mund të mos ndodhë në sektorin privat. Në rast se ndodh kjo e dyta, numri i kontribuesve do të bjerë më poshtë numrave të parashikuar duke i ngritur edhe më koeficientët e varësisë së sistemit. Gjithashtu, është me rëndësi të mbahet parasysh që objektivi i politikave të qeverisë është njehësimi i pensioneve rurale me ato urbane. Në rast se kontribuesit e sektorit rural vazhdojnë të paguajnë vetëm 15 përqind të kontributit të nevojshëm dhe të përfitojnë të drejta të plota nga sistemi i pensionit, kjo është njësoj sikur 85 përqind e kontribuesve në sistemin rural të mos paguanin. Në rast se përjashtoheshin 85 përqind e kontribuesve ruralë, koeficientët e varësisë së sistemit do të arrinin shifra alarmante në afërsisht 136 përqind në të ardhmen, ç'ka do të thotë që çdo kontribues i vërtetë duhet të mbështesë 1.36 pensionistë në mënyrë që sistemi të jetë i vetë-financueshëm.

Figura 4.1: Koeficienti i varësisë së moshës së thyer parashikuar për Shqipërinë, 2004-2072



29. Figura 4.3 tregon në mënyrë eksplicite ndikimin e përqindjes aktuale të ulët të kontribuesve si përqindje e popullsisë në moshë pune, mbi numrin e të moshuarve që u takon pension pleqërie në të ardhmen. Të moshuarit e ardhshëm që u takon pension përshijnë të gjithë burrat nga moshë 65 vjeç e lart që marrin pension pleqërie, pension për paaftësi apo pensionet për individët e mbetur të ve dhe të gjitha gratë nga 60 vjeç e lart për të gjitha kategoritë e lartpërmendura. Emëruesi është numri i burrave nga moshë 65 vjeç e lart dhe numri i grave nga moshë 60 vjeç e lart. Ndërsa niveli aktual shumë i lartë i të moshuarve që marrin pensione reflekton qartë mashtrim dhe/ose të dhëna të dobta, parashikimi afatgjatë tregon se pak më pak se 60 përqind e të moshuarve do të marrin pension të çfarëdo lloji në të ardhmen dhe për mbi më

shumë se 10 përqind e personave që përfitojnë pension, ky pension do të jetë një pension për individët e mbetur të ve, që ofron vetëm gjysmën e një pensioni normal. Figura 4.3 sugjeron që ndërsa aktualisht mund të ekzistojë një problem administrativ për të evdientuar në mënyrë korrekte personat që u takon pension dhe personat që mund të mos kenë të drejtë për të përfituar nga pensioni, në periudhën afatgjatë, qeveria do të përballlet me një problem social në lidhje me trajtimin e problemit për të gjithë këta të moshuar, të cilët nuk kanë të ardhura në pleqëri.

Figura 4.2: Koefficientët e varësisë së sistemit të parashikuara në sistemet e pensioneve urbane dhe rurale në Shqipëri





Figura 4.3: Numri i parashikuar i pensionistëve të moshuar në të ardhmen në krahasim me popullsinë e moshuar në Shqipëri




30. Parashikimet demografike kombinohen me disa supozime mbi variablet makroekonomike për të prodhuar parashikimet financiare. Tabela 4.2 bën një përmbledhje të variave kryesore makroekonomike të përdorura tek parashikimet.

Tabela 4.2: Supozimet makroekonomike

Simulimet makroekonomike	2004	2005	2006	2010	2025	2050	2075
Rritja reale e GDP-së	6.0%	5.5%	5.0%	6.0%	5.8%	5.4%	5.0%
Rritja reale e pagave	4.0%	4.0%	4.0%	5.0%	4.9%	4.8%	4.7%
Përqindja e inflacionit	2.5%	2.2%	2.5%	3.0%	2.8%	2.4%	2.0%
Koeficienti i skontimit real	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%	3.0%

31. Nga pikëpamja e politikave, rezultatet fillestare janë modeluar sipas ligjit në fuqi, ku thuhet se si pensioni minimal, ashtu edhe pensionet në progres do të indeksohen me indeksin e çmimit, potencialisht me një shportë pak më të ndryshme mallrash nga indeksi i çmimit të konsumatorit që i takon të gjithë ekonomisë. Nga pikëpamja fiskale, parashikimet flasin jo vetëm për një sistem të qendrueshëm nga pikëpamja fiskale, por për një sistem që tregon teprica të mjaftueshme të cilat qeveria mund t'i përdorë lehtësisht për të ulur taksat e punës në të ardhmen, siç del nga Figura 4.4. Aktualisht sistemi urban është me deficit, gjë që e fut të gjithë sistemin në deficit. Ky deficit do të ndërrojë kahje kur indeksi de facto i inflacionit të pensionit maksimal të nisë të shkurtojë ndjeshëm përfitimet. Sistemi rural aktualisht është me teprica për disa arsye. Së pari, të paktë janë ata të moshuar që kanë të drejta të mjaftueshme nga sistemi për të përfituar pension të plotë dhe shumica e tyre merr pension të pjesshëm. Së dyti, edhe pensioni i plotë minimal në sistemin rural është aktualisht pothuajse gjysma e pensionit të plotë minimal në sistemin urban, ndonëse pritet që të barazohen aty nga viti 2012. Por në të njëjtën kohë, kontributet aktuale po vlerësohen me pagën minimale të të vetë-punësuarve urbanë, ku shteti paguan shumicën e kontributit. Në rast se shteti e heq kontributin e plotë, sistemi i kombinuar do të shfaqë vetëm një deficit të vogël për vitet 2004- 05 përpara se të kthehet tek teprica. Edhe me ngritjen e përfitimeve rurale në nivelin e minimumit urban sipas legjislacionit, sistemi vazhdon gjatë gjithë kohës të mbetet me tepricë. Kjo tepricë bie pak në rast se subvencionet rurale për kontribuesit netohen nga teprica, por teprica gjithësesi mbetet tek 4 përqind e GDP-së në periudhën afatgjatë.


Figura 4.4: Balancat e parashikuara fiskale të sistemit të pensioneve sipas legjislacionit në fuqi



32. Megjithatë, ndërsa kjo politikë sipas legjislacionit aktual mund të jetë e qendrueshme nga pikëpamja fiskale, ajo rezulton në një rënie kaq të ndjeshme të përfitimeve sa që nuk mund të jetë politikisht e përballueshme. Figura 4.5 tregon nivelin e përfitimeve në lidhje me pagën mesatare.

Për pensionistët urbanë, përfitimet vazhdojnë të bien gjatë gjithë periudhës së simulimit, me përjashtim të dy viteve të para gjatë të cilëve pensionet u rritën shumë më lartë sesa niveli i inflacionit. Në vitet 2005-06, pensionet në sistemin urban u rritën me 8 përqind dhe 5 përqind përaktësisht, shifra këto shumë më të larta nga përqindjet e inflacionit prej 2.5 përqind dhe 2.2 përqind. Përfitimet rurale nisin me një model tjetër, por përfundojnë pothuajse njësoj. Në fillim, qeveria ndjek një model të rritjes së pensioneve rurale shumë më shumë nga pensionet urbane çdo vit duke u përpjekur të vendosë shenjën e barazimet mes pensioneve minimale deri në vitin 2012. Kështu, në vitin 2005 dhe 2006, pensionet rurale u rritën me 15 përqind në vit, një rritje kjo shumë më e lartë sesa për pensionet urbane dhe disa herë më e lartë nga përqindja e inflacionit. Në Figurën 4.5, kjo politikë tregon një rritje të lartë të pensioneve në krahasim me pagën mesatare gjatë 8 muajve të parë të periudhës së simulimit, më rënie të mëpasshme kur pensionet indeksohen plotësisht me inflacionin. Pensionet në shumë vende lidhen me inflacionin, pa rënie të ndjeshme të përfitimeve. Legjislacioni shqiptar lidh jo vetëm pensionet që paguhen aktualisht dhe pensionin minimal me inflacionin, por duke lidhur pensionin maksimal me pensionin minimal, përfundon duke lidhur pensionin maksimal edhe me inflacionin. Me rritjen e pagave në ekonomi në përgjithësi, pensionet, edhe për pensionistët e sapo dalë në pension, kufizohen në terma reale tek i njëjti pension me individët që kanë dalë në pension 20 vjet më parë, duke çuar në nivele të ulta të përfitimeve mesatare. Duhet mbajtur parasysh se ndërsa përfitimet urbane janë pothuajse dyfishi i nivelit të përfitimeve rurale, përfitimet në Figurën 4.5 paraqiten në lidhje me pagën mesatare mbi të cilën paguhen kontributet në çdo nën-sistem.

Figura 4.5: Ndryshimi i parashikuar për përfitimet në rast se rritjet vjetore përcaktohen me ligj




33. Kjo politikë sipas ligjit aktual nuk mund të jetë e qëndrueshme për një numër arsyesh. Pensionet kanë dy qëllime: (i) të zbusin varfërinë në moshë të thyer, dhe (ii) të shërbejnë si një mekanizëm që ndihmon individët për zbutjen e konsumit gjatë jetës në mënyrë që kur të mos jenë më në gjendje të fitojnë të ardhura, nivelet e tyre të konsumit të mos bien në mënyrë drastike. Duke supozuar se niveli i pensionit është i mjaftueshëm për të blerë një shportë të caktuar mallrash të nivelit të varfërisë, mbajtja e këtij niveli konstant edhe me rritjen e pagave do të eliminojë varfërinë absolute midis të moshuarve, ndonëse pensionistët sërish do të mbeten të varfër krahasimisht me personat që punojnë dhe nxjerrin të ardhura. Por objektivi i dytë i sistemit të pensioneve, që ka të bëjë me zbutjen e konsumit, nuk mund të arrihet në një kuadër të tillë. Individët që përfitojnë paga do të ndjejnë një rënie të ndjeshme të nivelit të tyre të konsumit me daljen në pension. Kjo rënie e ndjeshme në standardin e jetesës për individët me të ardhura të

mesme dhe të larta nuk do të jetë e përballueshme nga pikëpamja politike, po nuk u gjetën mekanizma të tjera për zbutjen e nivelit të konsumit për këtë kategori. Së dyti, taksat tejet të larta të borderosë, që shkaktojnë devijime të ndjeshme në tregjet e punës, po përdoren për lehtësimin e varfërisë të një pjese të të moshuarve, vetëm për ata që kanë kontribuar dhe shumë nga këta individë mund të mos jenë fare të varfër, ndërsa ka të tjerë që janë të varfër dhe nuk kanë mundësi të përfitojnë. Së treti, asnjë individ nuk do të kontribuonte me dëshirë 29.9 përqind të pagës së tij për 35 vjet ose më shumë vetëm për të marrë një përfitim të barabartë ose më të ulët nga 5 përqind e pagës mesatare për 15-20 vjet. Rrjedhimisht, ato pak stimuj që ekzistojnë aktualisht për të kontribuar në këtë sistem, do të reduktohen ndjeshëm bashkë me të ardhurat, duke e bërë sistemin nga pikëpamja fiskale të paqendrueshëm dhe nga ana politike të papërballueshëm.


34. Praktikisht, autoritetet shqiptare nuk e kanë ndjekur legjislacionin dhe i kanë dhënë pensionet më shumë në përputhje me të ardhurat që sigurojnë. Në rast se pensionet do të indeksoheshin plotësisht për pagat, gjë që efektivisht rrit pensionet me të ardhurat e arkëtuara duke qenë se gjatë periudhës së simulimit popullsia në moshë pune nuk do të bjerë, e kundërta ndodh kur pensionet janë të pranueshëm nga pikëpamja sociale, duke futur edhe mungesën e stimujve për personat me të ardhura të larta siç është diskutuar më lart, por ato bëhen më pak të qendrueshme nga pikëpamja fiskale siç tregohet në Figurën 4.6. Deficiti i përgjithshëm del në 0.4 përqind të GDP-së, por arrin maksimumin në 1.1 përqind në mes të periudhës. Por duhet mbajtur parasysh që qeveria paguan gjithashtu 85 përqind të kontributit për të punësuarit në sektorin rural, që çon në 1 përqindsh tjetër të GDP-së. Në kulmin e saj, shteti do të duhet të vendosë 2.8 përqind të GDP-së si burime fiskale të sigurojë pensione për vetëm 75 përqind të të moshuarve, siç tregohet në Figurën 4.6. Një vështrim më i thelluar në financat e sistemit urban tregon se deficiti fillimisht përmirësohet dhe pastaj përkeqësohet sërish, por nga fundi i periudhës nis të përmirësohet sërish. Përmirësimi fillestar vjen nga rritja e moshës së daljes në pension. Me zbatimin dhe absorbimin e plotë të ndryshimit në moshën e daljes në pension, deficit përkeqësohet sërish. Nga mesi i periudhës, fillon të dalë në pension pjesa e të punësuarve të post-tranzicionit. Duke qenë se një numër më i vogël prej këtyre të punësuarve do të kenë të drejtë për të përfituar nga sistemi i pensioneve, numri i pensionistëve fillon të bjerë dhe rrjedhimisht e njejta gjë ndodh edhe me shpenzimet për pensionet. Nga pikëpamja e sistemit rural, përkeqësimi i ndjeshëm fillestar nis nga rritja e shpejtë e nivelit të përfitimeve në kuadrin e përpjekjeve për të barazuar përfitimet urbane me ato rurale. Duke qenë se përfitimet urbane tani po rriten më shpejtë me indeksimin e pagës, përfitimet rurale duhet të rriten akoma edhe më me shpejtësi. Momentin që përfitimet njehësohen, ritmet e rritjes së deficitit ngadalësohen. Sistemi rural nuk tregon të njëjtin përmirësim me sistemin urban sepse mungesa fillestare e balancës midis përqindjes së individëve që përfitojnë dhe përqindjes që kontribuojnë, që po korrigjohet në sistemin urban, nuk ekzistonte në sistemin rural.

Figura 4.6: Balanca e parashikuar fiskale në rast se përfitimet e pensioneve indeksohen plotësisht për pagat



35. Nga pikëpamja e përfitimeve, përfitimet sigurisht janë shumë më të mira sipas sistemit të indeksimit për pagën, siç tregohet në Figurën 4.7. Përfitimet urbane mbeten tek afërsisht 40 përqind e nivelit të pagës mesatare. Përfitimet rurale ngrihen në një nivel shumë më të lartë, sërish bazuar në njehësimin midis përfitimeve rurale dhe nivelit të pensionit minimal urban. Koeficienti i lartë i zëvendësimit krahasuar me pagën minimale që aplikohet për të vetë-punësuarit urbanë, që mund të jetë edhe një pagë e lartë në krahasim me atë që marrin të punësuarit në sektorin rural aktualisht sjell në vëmendje çështjen nëse është plotësisht me vend të barazohen nivelet e pensioneve midis të punësuarve ruralë dhe atyre urbanë. Pensionistët ruralë dhe urbanë mund të kenë nevoja të ndryshme dhe dhënia e pensioneve shumë më të larta në krahasim me pagat për të cilat ata kanë kontribuar dhe nga e cila kanë paguar vetëm 15 përqind të kontributeve mund të rezultojë në një mbi-kompensim për pensionistët rural në kurriz të gjithë pjesës tjetër të ekonomisë.

Figura 4.7: Përfitimet e parashikuara në rast se të gjitha parametrat e përfitimeve do të indeksoheshin sipas pagës



36. Praktikisht, qeveria mund të zgjedhë një rrugë të mesme midis modelit të indeksuar plotësisht për çmimin dhe modelit të indeksuar plotësisht për pagat, diçka të mesme, që nga

pikëpamja fiskale do të ishte më e shëndoshë. Megjithatë, dallimi midis dy grupeve të shifrave sugjeron që gjithmonë do të duhet të gjendet një balancë në kuadrin e grupit të parametrave aktualë. Çdo skemë indeksimi që është e shëndoshë nga pikëpamja fiskale nuk do të sjellë përfitime as në nivelin bazë të përfitimeve të përcaktuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) që është 40 përqind i pagës mesatare për 30 vjet pune. Çdo indeksim, që siguron nivelin bazë të përfitimeve, do të jetë i kushtueshëm dhe sërish do të lërë një përqindje të madhe të të moshuarve pa përfitime. Vlen të ritheksohet se të gjitha këto parashikime bazohen në simulime konservatore dhe optimiste sipas të cilave individët do të punojnë të gjitha vitet e punës që u takon të punojnë, siç ka qenë në të kaluarën. Siç është theksuar edhe më parë, stimujt e sistemit nuk funksionojnë në këtë drejtim. Në rast se individët reagojnë ndaj këtyre stimujve, situata fiskale do të përkeqësohet pavarësisht nga mekanizmi i indeksimit dhe përfitimet mund të jenë gjithashut më të këqia duke qenë se një numër më i madh individësh mund të marrin përfitime të pjesshme në vend të përfitimeve të plota.

37. Problemet e sistemit aktual mund të përmbliidhen si më poshtë vijon:

- Mbulesë e pamjaftueshme e të moshuarve në periudhën afatgjatë, ku 40 përqind e të moshuarve në të ardhmen nuk do të kenë mundësi të përfitojnë nga sistemi i pensionit;
- Rënie e ndjeshme e përfitimeve që lind nga lidhja që i bëhet pensionit maksimal me inflacionin;
- Përqindje të larta kontributive që nuk përbëjnë stimul për formalizimin e krahut të punës;
- Mungesa e stimujve në formulën e përfitimit që individët të deklarojnë pagat e plota apo të punojnë gjatë gjithë moshës së tyre të punës; dhe
- Mbi-favorizim i të punësuarëve në sektorin rural dhe pensionistëve.

V. OPCIONET E POLITIKAVE

38. Sot, autoritetet shqiptare i njohin problemet në sistemin e pensioneve dhe janë përpjekur t'i riparojnë ato përmes ndryshimeve të vogla në sistemin aktual të pensioneve. Kështu, p.sh ligji fillestar e përcaktonte kufirin për pagat subjekt i kontributeve tek dyfishi i pagës mesatare. Për të siguruar më shumë të ardhura, autoritetet e ndryshuan këtë tavan në pesëfishin e pagës mesatare. Për të shmangur një indeksim mbi-favorizues të pensioneve, autoritetet shqiptare vendosën rregullin që pensioni minimal dhe pensionet që janë duke u paguar duhet të indeksoheshin sipas ndryshimeve në çmimet e shportës specifiku të përcaktuar të mallrave. Kohët e fundit, si kundrapërgjigje ndaj kostos së lartë të krahut të punës dhe evazionit, autoritetet shqiptare kanë kaluar në përqindje më të ulta kontributesh për sigurimet shoqërore në përgjithësi, duke përfshirë përqindjen e kontributeve për pensionet.

39. Qeveria meriton lëvdata për njohjen e problemeve momentin kur ato lindin dhe për përpjekjet që bën për trajtimin e tyre si kundrapërgjigje. Megjithatë, disavantazhi i kësaj qasjeje është se pas shumë arnimeve që u janë bërë ligjeve, ligji nis të humbë konsistencën. Çdo ndryshim i miratuar ndihmon për zgjidhjen e një problemi që ka lindur, por prish diçka tjetër. Kështu, p.sh. përpjekja për rritjen e të ardhurave përmes rritjes së tavanit të kontributeve deri në pesëfishin e pagës mesatare mund të ketë përmirësuar të ardhurat në periudhën afatshkurtër, por duke qenë se nuk është shoqëruar me ndryshime në formulën e përfitimit, stimujt që individët me të ardhura të larta të raportojnë të ardhurat e tyre të vërteta dhe të paguajnë kontribute për to janë përkeqësuar ndjeshëm. Eventualisht do t'ia vlente një rivlerësim i sistemit të pensioneve dhe të mendohej nëse sistemi aktual mund të arrijë objektivat që qeveria do të donte të arrinte ose nëse një strukturë alternative do të ishte më mirë. Ky seksion përpiqet të parashtojë opcionet që ka qeveria në trajtimin e strukturave alternative.

40. Aktualisht, nga sistemi i pensioneve kërkohet një rishpërndarje substanciale për sektorin rural, një rishpërndarje substanciale për të varfërit në zonat urbane, kërkohet të jetë i qendrueshëm nga pikëpamja fiskale, të sigurojë stimuj për formalizimin e tregut të punës dhe të garantojë pensione të arsyeshme për të gjithë individët, dhe të gjitha këto vetëm me një instrument. Këto janë shumë objektiva për një instrument të vetëm. Një qasje e përshtatshme mund të ishte ndarja e këtyre objektivave në së paku dy grupe dhe përdorimi i një instrumenti për të arritur njërin nga objektivat dhe i një instrumenti tjetër për të arritur objektivat e tjerë. Një opcion do të ishte heqja e rishpërndarjes nga sistemi kontributiv dhe riformulimi i parametrave me qëllim arritjen e qendrueshmërisë fiskale, një lidhje e ngushtë midis kontributeve dhe përfitimeve, që heq shumë nga shkurajimet aktuale për pjesëmarrje dhe ofron pensione të arsyeshme për personat që kontribuojnë. Rishpërndarja që është aktualisht e futur në sistemin e pensioneve do të duhet të sigurohet me anë të ndonjë instrumenti tjetër, si p.sh nga një pension asistence sociale disponibël për të gjithë të moshuarit, p.sh. poshtë një niveli të caktuar të ardhurash. Një opcion alternativ do të ishte zhvendosja e fokusit të sistemit publik të pensioneve drejt rishpërndarjes, me objektiv themelor zbutjen e varfërisë tek të moshuarit, që do të financohet nga të ardhurat e përgjithshme ose me një kontribut të vogël në një përqindje aq të ulët sa të mos rëndojë në kurriz të tregjeve të punës. Garantimi zbutjes së konsumit përmes pensioneve të arsyeshme për individët me të ardhura të mesme dhe të larta do të jetë përgjegjësi e një sistemi privat pensionesh, në të cilin do të kenë mundësi përfitimi të gjithë të punësuarit që zgjedhin një sistem të tillë. Ky sistem privat do të ishte pothuajse neutral nga pikëpamja fiskale,

vetëm me disa avantazhe të kufizuara tatimore për kursimet e pensioneve private. Sipas të dy opsioneve, burimet e nevojshme fiskale do të kenë si synim uljen e varfërisë tek të moshuarit dhe të paaftët, përmes garantimit të një pensioni bazë për gjithë të moshuarit dhe të paaftët ose përmes sigurimit të një pensioni social për individët që nuk kanë pensione kontributive.

41. Pjesa tjetër e këtij seksioni hedh një vështrim mbi implikimet e secilës prej këtyre strategjive nga pikëpamja fiskale, nga pikëpamja e përfitimeve, nga pikëpamja e mbulesës, si edhe nga pikëpamja e stimujve që ofrohen. Megjithatë, duhet theksuar se brenda secilit prej këtyre opsioneve diskrete ka shumë nën-opsione. Këtu paraqitet vetëm një shembull për secilin prej opsioneve. Opcionet e paraqitura nuk janë domosdoshmërisht optimale, por janë përdorur thjesht për të ilustruar rezultatet potencialisht të ndryshme sipas këtyre opsioneve. Momentin që autoritetet shqiptare vendosin mbi zgjidhjen e opcionit diskret më të përshtatshëm për rastin e Shqipërisë, atëherë mund të provohen dhe testohen nën-opsionet specifike për të përcaktuar natyrën ekzakte të parametrave, që do të garantonin modelin më të mirë për vendin.

Opcioni 1

42. Ky opcion ka të bëjë me ristrukturimin e sistemit aktual kontributiv, rritjen e stimujve për të kontribuar dhe eliminimin e shumicës së subvencioneve. Njëkohësisht, sistemi do të shoqërohet me një pension bazë jokontribues, që do të jepet për të gjithë individët që nuk janë në gjendje ose nuk janë të gatshëm të kontribuojnë. Parametrat specifike që janë përzgjedhur për të ilustruar Opcionin 1 paraqiten në Tabelën 5.1, më poshtë. Opcioni 1 ka të bëjë me uljen e përqindjes së kontributit me 6 pikë përqindjeje, në përputhje me punën e bërë që nga 1 shtatori në sistemin aktual. Ky opcion e mban moshën e daljes në pension të njejtë me rastin aktual, ndonëse mosha e daljes në pension, në veçanti për gratë, është ende e ulët sipas standardeve ndërkombëtare. Ndryshimet e mëdha janë në formulën e përfitimit. Në vend të ofrimit të një pensioni bazë dhe 1 përqind të pagës personale për çdo vit pune, Opcioni 1 ofron 1.3 përqind të pagës personale për çdo vit shërbimi. Kjo përqindje për çdo vit pune është zgjedhur si një përqindje e qendrueshme nga pikëpamja fiskale duke marrë në konsideratë përqindjen e re të kontributit prej 23.9 përqind. Kombinime të ndryshme të përqindjeve të kontributit dhe koeficientëve përritës (*në anglisht-accrual rates*) gjithashtu mund të jenë të qendrueshme nga pikëpamja fiskale dhe mund të shihen si nën-opsione të ndryshme. Në rast se qeveria do të dëshironte të fuste sërish disa elementë të rishpërndarjes në formulën e përfitimit, mund të futej një pension i vogël bazë me një koeficient përritës më të ulët krahasimisht me pagën personale, duke mbajtur në konsideratë një koeficient zëvendësimi si objektiv në gamën 40-50 përqind. Megjithatë, po të zgjedhë shtesën e një pensioni bazë, qeveria duhet të mbajë parasysh propabilitetin e uljes së tepërmi të stimullit për të kontribuar për të punësuarit me të ardhura të larta.

43. Të punësuarit në sektorin rural do të kenë mundësi zgjedhjeje. Në rast se zgjedhin të marrin pjesë në sistemin e pensionit urban, janë të lirë ta bëjnë një gjë të tillë për sa kohë janë të gatshëm të paguajnë kontributin e plotë, me të njejtën bazë page si të punësuarit urbanë, pa subvencion nga shteti. Në rast se nuk janë të gatshëm apo nuk munden të sjellin kontributet e tyre në këtë nivel, kërkesa e tyre për të kontribuar do të eliminohet, duke rritur të ardhurat për popullsinë në moshë pune të këtij grupi. Megjithatë, pensionet e tyre do të jenë pensioni aktual rural i indeksuar për inflacionin. Praktikisht ata do të kenë të njejtën fuqi blerëse që kanë arritur

aktualisht pensionistë rurale. Në të ardhmen, qeverisë mund t'i duhet të vlerësojë nevojat minimale të një pensionisti në zonat rurale dhe të përcaktojë nivelin e përfitimeve në përputhje me këto nevoja. Sistemi aktual i pensioneve rurale në këtë shembull do të zgjidhet thjesht për të lehtësuar tranzicionin nga një sistem në tjetrin. Në këtë shembull nuk parashikohet periudhë tranzicioni për pensionistët e zonave rurale, në mënyrë që pavarësisht nga fakti nëse kanë kontribuar apo jo në të kaluarën ata do të marrin të njejtin përfitim. Nënopcionet mund të përfshijnë disa shtesa të vogla për individët që kanë kontribuar në të kaluarën, në përputhje me vitet e kontributeve, por duke patur parasysh faktin që pjesa dërmuese e kontributeve vjen nga shteti, kjo shtesë nuk është përfshirë në shembullin e modeluar. Së fundi, ndërsa sistemi kontributiv ul numrin e të moshuarve të cilëve u jep pensione, sistemi i ri rural do të risë numrin e të moshuarve që u jep një përfitim në përpjekje për të mbuluar të gjithë popullsinë. Eventualisht nuk do të ketë më një sistem urban dhe një sistem rural, por një sistem kontribues dhe një jokontribues ku individët si në zonat urbane, ashtu edhe në ato rurale të jenë në gjendje të përfitojnë nga secili prej këtyre sistemeve sipas gatishmërisë apo aftësisë së tyre për të kontribuar.

Tabela 5.1: Parametrat e përdorur për të ilustruar Opcionin 1


Parametrat për Opcionin 1 në krahasim me sistemi aktual		
Parametri	Sistemi aktual	Opcion 1
Përqindja e kontributit	29.9 përqind ⁴	23.9 përqind
Mosha e daljes në pension	Do të rritet në 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë në vitin 2012	E njejtë
Përqindja e përfitimit	Pensioni bazë + 1 përqind në vit të mesatares jetike të rivlerësuar sipas rritjes së kontributeve mesatare; Në varësi të limiteve të shtrënguara të pensionit maksimal; pensioni nuk mund të jetë më i lartë se dyfishi i shumës bazë ose 75 përqind e pagës mesatare neto për 3 vjet pandërprerje gjatë 10 vjetëve të fundit të punësimit, cilado shifër të jetë më e ulta;	1.3 përqind në vit i mesatares jetike i rivlerësuar sipas rritjes së pagave mesatare; pensioni maksimal i vitit 2007 rritur në pesëfish të vlerës aktuale; i indeksuar më vonë sipas rritjes së pagës
Indeksi i pensioneve pas daljes në pension	Inflacioni sipas legjislacionit/ shpesh më i lartë në realitet	Inflacioni
Sistemi i pensioneve rurale	Përfitimet parashikohen të jenë identike me ato të ofruara nga sistemi urban në vitin 2012; kontribut në shumë fikse, ku shteti plotëson diferencën midis saj dhe përqindjes së kontributit urban të paguar mbi pagën minimale në sektorin urban	Eliminohet sistemi i veçantë kontributiv; individët që dëshirojnë të kontribuojnë sipas përqindjeve të plota të sektorit urban janë të lirë ta bëjnë një gjë të tillë; të tjerët marrin përfitime mbi baza jokontributive në nivelin e sotshëm të pensioneve rurale, të mbajtur konstant në terma reale

44. Figura 5.1 tregon balancën e parashikuar financiare për secilin nga sistemet. Sistemi urban ose kontributiv ruan një balancë financiare gjatë pjesës më të madhe të periudhës, me një tepricë të vogël drejt fundit. Rritja fillestare e deficitit vjen nga ulja e përqindjes së kontributit.

⁴ Me datë 1 shtator 2006, koeficientët e kontributit u redukuan në 23.9 përqind.


Teprica në fund sugjeron që ka hapësirë fiskale në të ardhmen për të ulur edhe më tej përqindjet e kontributit ose për t'i bërë përfitimet pak më bujare. Në të ardhmen do të ketë më shumë hapësirë për të ecur në këto drejtime duke rritur moshën e daljes në pension për gratë në 65 vjeç dhe duke e rritur moshën e daljes në pension për të gjithë nga 65 vjeç në mosha më të mëdha në përputhje me rritjen e pritshmërisë jetike në periudhën afatgjatë. Nga pikëpamja rurale ose jokontributive, eliminimi i kërkesës për kontribute do ta fusë sistemin rural menjëherë në deficit dhe do të bazohet tërësisht në burimet fiskale. Megjithatë, me një rritje të vazhdueshme të GDP-së dhe një pension social, niveli i së cilës rritet vetëm me inflacionin, pavarësisht rritjes së numrit të përfituesëve në të ardhmen, shuma e burimeve fiskale të nevojitura do të bierë krahasimisht me GDP-në nga niveli fillestar i 0.7 përqind i GDP-së. Vija në fund tregon se totali i burimeve fiskale që nevojiten do të jetë më i ulët sipas Opcionit 1 sesa në rastin bazë, duke supozuar që rritjet e pensioneve do të ndjekin kursin aktual të rritjes me pagat, me përjashtim të 2 veteve të para kur shteti do të absorbojë si eliminimin e kontributeve në sistemin rural, ashtu edhe uljen e përqindjes së kontributeve për të punësuarit urbanë.

Figura 5.1: Balanca e parashikuar fiskale për sistemin urban të pensioneve sipas Opcionit 1



45. Çfarë ndodh me nivelin e përfitimeve? Figura 5.2 ilustron ndikimin e këtyre ndryshimeve në nivelin e përfitimeve. Për pensionistët në zonat urbane, pensionet do të bien nga nivelet e tyre aktuale, por më vonë do të qëndrojnë të pandryshuara ndryshe nga ligji aktual sipas të cilit bien në nivele tejet të ulta. Ndërsa niveli i pensioneve duket të jetë nën 30 përqind, kjo rënie i atribuohet kryesisht indeksimit të inflacionit pas daljes në pension. Pensionet e reja janë afërsisht 50 përqind e pagës mesatare për të punësuarit që kanë kontribuar për 35 vjet. Ky lloj indeksimi po bëhet gjithmonë e më tipik në të gjithë botën. Nga pikëpamja ekonomike, pensionistët shqetësohen për ruajtjen e fuqisë së tyre blerëse gjatë periudhës së pensionit dhe nuk kërkojnë rritje të fuqisë blerëse me kalimin e moshës.


Figura 5.2: Përfitimet e parashikuara për pensionisët me pension pleqërie sipas Opcionit 1



46. Për të punësuarit ruralë ose jokontributivë, pensionet do të bien krahasimisht me pagat mesatare. Kjo rënie ndodh sepse pagat vazhdojnë të rriten në terma reale, ndërsa përfitimet mbeten konstante. Duke qenë se përfitimi është jokontributiv dhe ka për qëllim uljen e varfërisë, qeveria duhet të shqetësohet në lidhje me sigurimin e një standardi absolut jetese për këta të moshuar dhe jo një standard jetese në krahasim me pagat. Përfitimet rurale ose jokontributive jepen krahasimisht me pagat mesatare urbane, në vend të paraqitjes krahasimisht me pagat e imputuara në sektorin rural për të bërë një krahasim të barabartë mbi nivelin e përfitimeve. Figura 5.2 paraqet përfitimet rurale si nën nivelin e përfitimeve urbane aktuale siç në fakt janë.

47. Mbulesa afatgjatë për të moshuarit, që ishte problematike sipas sistemit ekzistues gjithashtu përmirësohet ndjeshëm sipas Opcionit 1, siç tregohet në Figurë 5.3. Mbulesa 100 përqind nga sistemi si më lart mbetet e njëjtë në vitin 2005 sipas secilit rast. Shtylla e dytë bën krahasimin midis mbulesës sipas Opcionit 1 me mbulesën sipas Skenarit Bazë në vitin 2025. Mund të shihet që tani se sistemi kontributiv mbulon një numër më të vogël të moshuarish, sistemi jokontributiv nis të mbulojë një numër më të madh, duke ruajtur një mbulesë pothuajse të plotë. Në vitin 2075, sistemi kontributiv do të garantojë përfitime jo vetëm për një të tretën e të moshuarve ku shumica e pjesës tjetër do të mbulohet nga sistemi jokontributiv. Nuk është bërë një modelim i mbulesës së plotë sepse zakonisht ka devijime/shkarje, por edhe ajo mund të përfshihet. Gjithashtu, qeveria mund të zgjedhë të eliminojë sistemin jokontributiv si një sistem të ndarë administrative dhe në vend të tij t’u lejojë të moshuarve mundësi për të përfituar nga programi i Ndihmës Ekonomike. Sistemi jokontributiv që paraqitet këtu nuk kërkon testimet e hollësishme të sistemit që kërkohen nga Ndihma Ekonomike, por sërish mbeten për t’u parë shumë nën-opcione. Duke qenë se të ardhurat e të moshuarve janë tipikisht më pak variable sesa të ardhurat e popullsisë në moshë pune, një testim i hollësishëm vjetor i sistemit mund të jetë një barrë e panevojshme për të moshuarit.

Figura 5.3: Përqindja e të moshuarve që mbulohe nga sistemi i pensioneve me kalimin e kohës, sipas Opcionit 1



48. Krahasimi i fundit merr në shqyrtim stimujt sipas sistemit të ri. Figurat 3.4 dhe 3.5 tregojnë se sistemi ekzistues nuk përmban pothuajse asnjë stimul që individët me të ardhura të mesme dhe të larta të deklarojnë pagën e tyre reale dhe periudhën e stazhit të punës. Figura 5.4 paraqet stimujt sipas Opcionit 1. Nivelet e kthimit nuk janë shumë të ndryshme në grupe me të ardhura të ndryshme. Gratë kanë nivele më të larta kthimi sesa burrat për shkak të pritsshmërisë më të lartë jetike. Nivelet e kthimit janë më të ulta për individët me të ardhura të ulta sepse këta individë tipikisht nisin punë në moshë më të vogla duke qenë se nuk kalojnë kohë në arsimin e lartë dhe nga pensionet përfitojnë për një kohë më të shkurtër si pasojë e niveleve më të larta të vdekshmërisë që lidhen me individët me të ardhura të ulta.

Figura 5.4: Nivelet e brendshme të kthimit për Individët me nivele të ndryshme të ardhurash sipas Opcionit 1



49. Figura 5.5 krahason nivelet e përfitimeve, me pagat e fundit që të njëjtët individë parashikohen të kenë fituar. Grafiku tregon qartë që shumica e individëve do të marrin pensione të larta krahasimisht me të ardhurat e tyre të fundit, sidomos duke patur parasysh që pensionet

krahasohen me të ardhurat bruto nga të cilat zbriten kontributet dhe taksat, asnjë prej të cilave nuk zbritet nga pensioni. Këto shifra për individët me të ardhura të mesme dhe të larta duken si më të larta duke qenë se këta të punësuar kalojnë një rënie normale të pagës në vitet e mëvonshme. Nga ana tjetër, pensioni i tyre bazohet në të ardhura që përfshijnë vitet e tyre më produktive dhe me të ardhura më të larta, duke e ngritur pensionin në krahasim me pagën e fundit. Për individët me të ardhura të larta, të cilët përpara daljes në pensione mund të kenë patur poste të rëndësishme drejtuese dhe që marrin rritje të mëdha page derisa dalin në pension, pensioni i bazuar në vitet fillestare të punës kur të ardhurat ishin më të pakta do të jetë më i ulët krahasimisht me pagën e tyre përfundimtare.

Figura 5.5: Përfitimi i pensionit krahasimisht me pagën e fundit personale për individë me të ardhura të ndryshme, sipas Opcionit 1



Opcioni 2


50. Sipas Opcionit 2, qeveria bën lëvizje në kahje të kundërt, duke e patur të qartë se sistemi ekzistues është tepër rishpërndarës dhe ofron pak stimuj për të kontribuar nga ana e individëve me të ardhura të mesme dhe të larta, porse në të njëjtën kohë nuk mbulon të gjithë popullsinë e moshuar në periudhën afatgjatë. Sipas këtij opcioni, qeveria shkon më tej drejt rishpërndarjes duke eliminuar sistemin kontributiv dhe duke futur një shumë fikse, të modeluar sipas shembullit në të njëjtin nivel si përfitimi aktual për zonat rurale që do të financohet nga të ardhurat e shtetit. Mund të simulohen modele për nivele të ndryshme përfitimesh. Në këtë rast u zgjodh niveli i përfitimit rural për të shmangur rritjen e përfitimeve për cilindo grup. Ky përfitim mund të ishte disponibël për të gjithë individët e moshës 65 vjeç e lart dhe do të indeksohet për inflacionin duke qenë se është modeluar për të ulur varfërinë, dhe jo për të zbutur konsumin.

51. Kostoja e garantimit të këtij përfitimi për të gjithë popullsinë e moshuar është çuditërisht e ulët, duke nisur tek 1.1 përqind e GDP-së dhe duke përfunduar tek 0.1 përqind e GDP-së, në fund të periudhës së simulimit. Rënia me kalimin e kohës ndodh sepse niveli real i përfitimit mbahet konstant dhe gjatë gjithë periudhës mendohet të ketë një rritje reale të GDP-së. Në vitin 2007, kostoja e pagesës së shpenzimeve për pensionet në të dy sistemet kontributeve si në atë rural edhe në atë urban parashikohet të jetë tek 4.2 përqind e GDP-së. Në krahasim me shifrën 1.1 përqind, kjo shifër duket e ulët. Megjithatë, siç është diskutuar edhe më parë, shpenzimet për

pensionet përfshijnë pagesa për 140 përqind të të moshuarve. Shumë nga këto të dhëna nuk duhet të jenë fiktive. Sipas përlogaritjes që bëhet për shumat fikse, do të evidentohet çdo individ i moshuar, i cili do të përfitojë vetëm një shumë të tillë. Për më tepër, niveli i përfitimit është ai i përfitimit rural dhe jo ai urban, që është së paku dyfishi i përfitimit rural. Duke qenë se dy të tretat e përfituesëve ekzistues vijnë nga sistemi urban, ulja e përfitimeve ul më tej kostot. Së fundi, burrat dhe gratë nuk e përfitojnë këtë shumë fikse përpara se të mbushin moshën 65 vjeçare duke nisur në vitin 2007, në krahasim me sistemin aktual ku mosha 65 vjeçare nuk do të jetë futur plotësisht në sistem deri në vitin 2012 për burrat dhe për gratë mosha e daljes në pension do të jetë 60 dhe jo 65. Duhet mbajtur parasysh që kontributi nga shteti për të punësuarit në sektorin rural në vitin 2007 do të arrijë në 1.5 përqind të GDP-së sipas sistemit aktual dhe mund të eliminohet sipas Opcionit 2, kështu që një shtesë si kompensim për lehtësimin e varfërisë për të gjithë të moshuarit është e mundur. Njëkohësisht, do të eliminoheshin plotësisht devijancat në taksën e punës.


52. Megjithatë, do të ketë një kosto tranzicioni në kalimin nga sistemi aktual kontributiv drejt një përfitimi social për të gjithë të moshuarit që do të financohet nga të ardhurat e përgjithshme. Personave që kanë dalë në pension sërish mbetet për t'ju paguar përfitimet aktuale në mënyrë që të shmangen problemet politike, ndërsa ata që kanë kontribuar presin të marrin diçka më të lartë nga shumë fikse, të cilin e përfitojnë individët që nuk kanë kontribuar. Në rast se qeveria do ta eliminonte sistemin kontributiv, nuk do të kishte të ardhura për pensionet, porse shtetit sërish do t'i duhej të paguante pensionet që janë aktualisht duke u paguar dhe për të drejtat që kanë përfituar për individët që kanë kontribuar. Këto pagesa përfaqësojnë koston e tranzicionit të kalimit në përfitimin social me shumë fikse. Figura 5.6 tregon koston e përgjithshme fiskale të Opcionit 2 me të gjitha kostot e tranzicionit, në rast se të gjitha kontributet do të eliminoheshin menjëherë, krahasimisht me skenarin bazë që kërkon indeksimin e plotë për pagat. Balanca fiskale ngrihet menjëherë në një deficit që arrin afërsisht 3.5 përqind të GDP-së, që është e njëjtë me shpenzimet në sistemin e pensioneve duke qenë se nuk ka të ardhura. Shpenzimet mendohen të jenë më të ulta se shpenzimet korrente duke qenë se sipas modelimit mendohet që çdo person i moshuar do të marrë vetëm përfitim kontributiv në rast se kualifikohen për përfitim kontributiv ose jokontributiv nëse nuk kualifikohen, ose në rast se përfitimi i tyre kontributiv do të ishte më pak se jokontributivi. Praktikisht, ndoshta do të duhej të kalonte më shumë se viti 2007 për të pastruar listat e përfituesve të vdekur ose pensionistët që nuk u takon të përfitojnë, por ky është thjesht një ilustrim. Ligji i ri nuk do të hartohet në kohë për zbatim as deri në janar të vitit 2007. Me rënien e të drejtave të përfituara në sistemin kontributiv, bien edhe koston e tranzicionit. Në vitin 2039 ato reduktohen në zero dhe kostoja e Opcionit 2 konsiston vetëm në ofrimin e një përfitimi social me shumë fikse, që mbahet konstant në terma reale dhe bie krahasimisht me një GDP në rritje. Megjithatë, deri në vitin 2019, kostoja e Opcionit 2 do ta tejkalojë koston e sistemit aktual të pensioneve sipas variantit më të kushtueshëm të indeksimit të pagës. Çështja shtrohet nëse shteti i ka burimet fiskale për të lançuar këtë opcion, që në periudhën afatshkurtër është shumë më i shtrenjtë sesa status quo-ja, por do të jetë shumë më efektiv nga pikëpamja e kostonë në periudhën afatgjatë si nga pikëpamja fiskale, ashtu edhe nga pikëpamja e uljes së kostonë së krahut të punës dhe përmirësimit të funksionimit të tregut të punës.

Figura 5.6: Kostot e parashikuara fiskale sipas Opcionit 2 me eliminimin total të kontributeve në vitin 2007




53. Një variant i Opcionit 2, që mund të jetë më i arritshëm nga pikëpamja fiskale, përfshin eliminimin e kontributeve për të punësuarit nën moshën 40 vjeçare në vitin 2007 dhe për krahun e ri të punës, duke i ruajtur ato për të punësuarit mbi moshën 40 vjeçare në vitin 2007. Në sistemin e sigurimeve shoqërore do të vazhdojnë të hyjnë disa të ardhura për 20-25 vjetët e ardhshëm, që do të ndihmojnë në mbulimin e disa detyrimeve që rrjedhin nga sistemi i vjetër. Të punësuarit që vazhdojnë të kontribuojnë do të përfitojnë pensione të plota kur të dalin në pension në vend që të përfitojnë vetëm të drejtat e tyre të përftuara deri në vitin 2007. Siç tregohet në Figurën 5.7, ky variant, Opcion 2A, i redukton kostot e tranzicionit që në fillim, por zgjat periudhën e kostos së tranzicionit në mënyrë të tillë që kostot e tranzicionit të mos bien në zero deri në vitin 2049, 10 vjet pas rastit kur të mos kontribuojë njeri në vitin 2007. Balanca që duhet vendosur midis një periudhe më të gjatë tranzicioni dhe kostove më të ulta fillestare mund të ishte një përpjekje të cilën qeveria ia vllente ta ndërmernte. Në këtë rast, deri në vitin 2010, kostot fiskale të Opcionit 2A janë nën ato të skenarit bazë me indeksimin e pagës. Shtetit do t'i duhet të paguajë kostot shtesë edhe për vetëm tre vjet të tjera dhe diferenca e kostos vjen në rënie gjatë periudhës tre vjeçare, duke nisur me 0.2 përqind të GDP-së në vitin 2007, dhe duke e bërë këtë një opcion më atraktiv nga pikëpamja fiskale sesa Opcioni 2.

Figura 5.7: Kostot e parashikuara fiskale sipas Opcionit 2A



54. Nga pikëpamja e përfitimeve, përfitimet duket qartë që janë më të ulta sipas Opcionit 2 dhe Opcionit 2A sesa në rastin e skenarit bazë me indeksim page për kontribuesit e sistemit urban siç tregohet në Figurën 5.8. Përfitimet kontributive bien në Opcionet 2 dhe 2A sepse individët që u bashkohen rradhëve të pensionistëve kanë më pak të drejta të përftuara nga ata të brezave të mëparshëm. Në pikën kur përfitimi jokontributiv bëhet më i lartë sesa përfitimi kontributiv, individët që marrin përfitimin kontributiv mendohet se marrin një kompensim, që i çon ata në nivelin e përfitimit jokontributiv. Kostoja e këtyre kompensimeve është përfshirë në parashikimet fiskale të dhëna në Figurat 5.5 dhe 5.6. Gjithësesi, në rast se ka probleme me pikën e nisjes për pensionin social dhe nivelin aktual të përfitimeve rurale, këto mund të rregullohen, por variantet për Opcionin 2 do të jenë pak a shumë si ato të paraqitura në Figurat 5.6-5.8. Ndërsa përfitimi jokontributiv luan qartazi një rol një uljen e varfërisë, ai nuk është në gjendje të luajë rolin e zbutjes së konsumit, siç del qartë nga Figura 5.8 ku vihet re qartë një rënie e ndjeshme e nivelit të tij krahasimisht me pagën mesatare. Instrumente të tjera, si p.sh. pensionet vullentare që tashmë ekzistojnë në Shqipëri do të duhet të plotësojnë rolin e zbutjes së konsumit. Legjislacioni duhet të rishikohet dhe ka shumë gjasa të ketë nevojë për amendamente në rast se duhet të luajë rolin kryesor të zbutjes së konsumit, por efekti do të ishte përcaktimi i instrumentëve të ndryshme për plotësimin e secilit prej objektivave të sistemit të pensionit.

Figura 5.8: Përfitimet e parashikuara sipas Opcionit 2 dhe 2A në krahasim me skenarin bazë të pensioneve urbane të indeksuara për pagën



55. Idealisht sistemi vullnetar duhet financuar në mënyrë që asnjë kompani, qoftë kjo publike apo private të mos ketë detyrime ekstra, të cilat eventualisht mund t'i kalohen shtetit. Manaxhimi privat i këtyre fondeve ia ka kaluar manaxhimit publik në shumicën e vendeve.⁵ Megjithatë, struktura ekzistuese institucionale e tregut financiar ka nevojë gjithashtu të rishikohet, si edhe nga pikëpamja e rregullave dhe mbikqyrjes për ta përcaktuar sa shpejt Shqipëria do të ishte në gjendje të hartonte një sistem pensionesh private që funksiononte në mënyrë aktive. Përveç rolit që një sistem i tillë mund të luajë në garantimin e përfitimeve për të moshuarit, një sistem i tillë do të përfitonte gjithashtu nga zhvillimi i tregjeve financiare në Shqipëri. Në periudhën e ndërmjetme, qeveria mund të krijonte një fond të veçantë për pensionet, me rregulla të qarta loje, me synim privatizimin e tij në të ardhmen.

⁵ Augusto Iglesias dhe Robert Palacios, *Managing Public Pension Reserves Part I: Evidence from the International Experience*, Social Protection Discussion Paper No. 0003, Departamenti i Mbrojtjes Sociale, Banka Botërore, janar 2000.

56. Pavarësisht nga pamundësia për të bërë zbutjen e konsumit sipas Opcioneve 2 dhe 2A, duhet theksuar se të dy opsionet do të sigurojnë uljen e varfërisë dhe eliminimin e përqindjes së kontributit që hap shqetësime dhe nuk krijon stimuj për hapjen e tregut formal të punës. Sistemi aktual nuk garanton as zbutjen e konsumit, dhe as uljen e varfërisë, po të mos jenë pensionet plotësisht të indeksuara për pagat, që do të thotë që nuk është i qendrueshëm nga pikëpamja fiskale.

57. Përsa i përket mbulesës, të gjithë shqiptarët nga mosha 65 vjeç e lart kanë të drejtën e përfitimit pavarësisht nga stazhi i punës, apo kontributet. Duke qenë se sistemi nuk do të financohet nga taksat e borderosë, nuk do të ketë ndikim negativ mbi tregun formal të punës dhe nuk do të përbëjë stimul për mosdeklarimin real të pagave siç ndodh aktualisht me sistemin ekzistues.

Opcione të ndërmjetme

58. Opcionet 1 dhe 2 parshtrajnë opinione tejet të ndryshme në lidhje me rolin e sistemit të pensioneve publike. Sipas Opcionit 1, të punësuarit urbanë ruajnë një sistem të modnë rast seikuar kontributiv, sipas të cilit shtet garanton një pension social për individët që nuk mundën apo që nuk janë të gatshëm të kontribuojnë, ndërsa sipas Opcionit 2, sistemi kontributiv hiqet dhe shteti garanton pension social për të gjithë. A ka ndonjë opcion të ndërmjetëm që ruan sistemin aktual kontributiv si për të punësuarit urbanë, ashtu edhe për ata ruralë, që ul përqindjen e kontributit nga nivelet e veta tejet të larta dhe është i qendrueshëm nga pikëpamja fiskale? Përgjigjia ka shumë gjasa të jetë negative. Ndërsa ekzistojnë përkëmbime në infinit për secilin nga opsionet, ruajtja e strukturës së përfitimit të sistemit aktual kontributiv dhe në të njëjtën kohë ulja e përqindjeve të kontributit ka pak gjasa të jetë e qendrueshme nga pikëpamja fiskale dhe të mundet të korrigjojë problemet/mangësitë e sistemit aktual.

59. Ulja e përqindjeve të kontributit sipas legjislacionit aktual me indeksimin për inflacionin të pensioneve që janë duke u paguar, pensioni minimal dhe faktikisht edhe pensioni maksimal mund të jenë të qendrueshëm nga pikëpamja fiskale, por përsa kohë që përqindjet e përfitimit në të ardhmen, siç tregohet në Figurën 4.5, do të jenë më të ulta se përqindjet aktuale të kontributit, askush nuk do të ketë stimul për të rritur kontributet. Me rënien e përqindjes së përfitimit, individët do të reagojnë përmes evazionit. Atëherë do të bien të ardhurat duke e bërë sistemin të paqendrueshëm nga pikëpamja fiskale. Në rast se përfitimet indeksohen sipas rritjes së pagës, atëherë sistemi siç është aktualisht nuk është i qendrueshëm nga pikëpamja fiskale dhe reduktimi i përqindjes së kontributit do të çojë vetëm në humbje të ardhurash.

60. E vetmja mundësi për të dalë nga kjo dilemë është në rast se individët dhe punëdhënësit do të reagonin ndaj uljes së përqindjeve të kontributit me anë të më shumë se një rritjeje proporcionale të formalizimit. Kështu, p.sh. në rast se përqindjet e kontributit ulen me 10 përqind, punësimi do të duhej të rritej me mbi 10 përqind për të siguruar më shumë të ardhura për sistemin e sigurimeve shoqërore. Ka disa faktorë që sugjerojnë që kjo nuk është e mundur. E para, përvoja ndërkombëtare tregon se çdo 1 përqind ulje në përqindjen e kontributeve rezulton

në 0.3 përqind rritje të punësimit.⁶ Një përgjigje kaq e kufizuar ndaj reduktimit të përqindjeve nuk do të ishte e mjaftueshme për siguruar më shumë të ardhura. Reagimi i kufizuar zakonisht i atribuohet faktorëve të ndryshëm nga modeli i sistemit të pensioneve, që kufizon formalizimin, si p.sh. ngurtësia në legjislacionin e punës. Së dyti, në Shqipëri ka disa disavantazhe brenda vetë modelit të sistemit të pensioneve që e pengojnë formalizimin. Së fundi, edhe në rasti se reagimi do të ishte i mjaftueshëm për sigurimin e të ardhurave, futja e më shumë individëve në një sistem të cilit i mungon balanca nga pikëpamja aktuariale në periudhën aftagjatë do të krijojë kosto shtesë. Në periudhën afatshkurtër, të ardhurat mund të rriten, por në periudhën afatgjatë, kontribuesit shtesë do të dalin në pension dhe do të rriten edhe më tej shpenzimet e ardhshme.

Avantazhet dhe disavantazhet e secilit prej opsioneve

61. Opcioni 1 ka avantazhin e garantimit të sistemit të sigurimeve shoqërore për individët që mund të paguajnë. Duke patur parasysh faktin që disa individë nuk janë në gjendje ose nuk janë të gatshëm të kontribuojnë, për këta individë ofrohet një sistem i veçantë që e parandalon sistemin e sigurimeve shoqërore të minohet nga shqetësimet për individët që nuk paguajnë. Nga ana tjetër, në të ardhmen do të ruhen përqindje relativisht të larta të kontributit nga borderoja. Do të ketë nevojë për investime të ndjeshme në infrastrukturën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me qëllim zbatimin edhe të një sistemi të sigurimeve shoqërore. Për më tepër, rezultati final nuk do të jetë një sistem i unnë rast seikuar për të gjithë shqiptarët, që do të rezultonte në fragmentime potenciale të tregut të punës, duke qenë se njerëzit hezitojnë të lëvizin, në veçanti nga sektori urban në atë rural, nga frika se mos humbasin përfitimet.

62. Opcioni 2 ose 2a mbart avantazhin e eliminimit të plotë të kontributeve nga borderoja, duke ua lehtësuar së tepërmi barrën punëdhënësve. Është një sistem shumë më i lehtë për tu administruar në perspektivën afatgjatë, ndonëse Opcion 2a që është më fizibël do të kërkonte që Instituti i Sigurimeve Shoqërore të ishte plotësisht operacional edhe për së paku 50 vjet të tjera. Në perspektivën afatgjatë, Institutit të Sigurimeve Shoqërore do t'i duhet thjesht të mbajë regjistrat e individëve që kanë arritur një moshë të caktuar dhe do të vërtetojë statusin e paftësisë. Por për 50 vjetët e ardhshëm kur individët që janë mbi 40 vjeç të vazhdojnë të kontribuojnë dhe të dalin në pension, do të duhet të mbahen regjistra për kontributet dhe pagesat e përfitimeve. Barazia që qeveria ka kërkuar të vendosë midis sektorit urban dhe atij rural do të arrihet gjithashtu, ndonëse jo përmes rritjes së pensioneve rural në nivelin e atyre urbane, por duke i sjellë pensionet urbane në nivelin e atyre rurale. Nga ana tjetër, nivelet e pensioneve do të jenë të ulta dhe shumica e individëve do të kërkojë shtesa. Nga pikëpamja politike është me rëndësi që qeveria të këmbëngulë që të gjitha shtesat të garantohen përmes kontributeve në shtyllën e sigurimeve vullnetare, në vend që të lejojë një zgjerim të gamës së përfitimeve të siguruara nga shteti. Megjithatë, me qëllim që ky të jetë një skenar me kuptim për individët, pensionet vullnetare do të duhet të jenë të rregulluara dhe të mbikqyrura mirë, gjë që kërkon një rritje të ndjeshme të kapaciteteve të autoritetit mbikqyrës.

⁶ Hamermesh siguron një anketim gjithëpërfshirës të studimeve empirike në lidhje me kërkesën për krah pune në një sërë vendesh dhe përlllogarit këtë konsensus. Përlllogaritjet dhe përmbledhja e studimeve mund të gjenden në Daniel S. Hamermesh, Labor Demand, Princeton University Press, 1996.

Zgjedhja e rrugës së reformave

63. Në përzgjedhjen e rrugës së reformave, qeveria duhet të marrë në konsideratë sa më poshtë vijon. Sipas të gjithë skenarëve, qeveria duhet të përmirësojë administratën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të përmirësojë regjistrimin si përsa i takon kontribuesve, ashtu edhe përfituesve dhe sidomos të këtyre të fundit.

64. Në rast se Opcioni 2 është opcioni i preferuar, qeveria duhet të mbajë në konsideratë sa më poshtë vijon:

- Pranueshmërinë politike të heqjes së konceptit të sigurimeve shoqërore dhe kalimin drejt një asistence sociale për të moshuarit, asistencë e cila do të jetë e financuar nga të ardhurat e përgjithshme;
- Burimi i financimit të pensionit social, që do të zëvendësojë pensionin kontributiv dhe burimi i financimit të pensioneve që kanë dalë në pension në sistemin e vjetër;
- Nivelin e pensionit social që do të ofrohet dhe si do të ndryshojë ky me kalimin e kohës (për të shmangur fryrjen e premtimeve sociale në të ardhmen);
- Popullsinë që do të dalë në pension gjatë sistemit të vjetër dhe ata që do të jenë pjesë e sistemit të ri;
- Njohja e të drejtave të përfuara të personave që kanë vite kontributesh në sistemin e vjetër, por që kalojnë në sistemin e ri;
- Ekzistenca e instrumenteve të mjaftueshme të tregut financiar për investime në kursimet e pensioneve vullnetare për individët që duan të përfitojnë më shumë sesa ç'garanton sistemi bazë social; dhe
- Ekzistenca e autoritetit të duhur rregullator dhe mbikqyrës të tregjeve të pensioneve vullnetare me qëllim që individët të kenë besim të mjaftueshëm për t'i përdorur ato për të rritur nivelin e pensioneve që do të përfitojnë si pension pleqërie.

65. Në rast se Opcioni 1 është opcioni i preferuar, qeveria duhet të mbajë në konsideratë sa më poshtë vijon:

- Nëse do të ishte politikisht e mundur të bëhej një ndarje e pensioneve të atyre që kontribuojnë aktualisht nga ata që nuk kontribuojnë, ndonëse kjo rrit pabarazinë
- Krijimi i një balance të re midis kontributeve dhe përfitimeve për periudhën afatgjatë, që ndofta do të ulë komponentin bazë të pensioneve në vend të vendosjes së një tavani mbi pensionin e përgjithshëm duke reduktuar nëse është e mundur përqindjen e kontributeve; dhe
- Numrin e individëve që dalin në pension sipas sistemit të vjetër dhe ata që janë pjesë e sistemit të ri, dhe përfitimet që do t'i garantohen secilit grup.

Banka Botërore rekomandon një sistem pensionesh me katër kolona. I pari shpesh njihet si shtylla zero, që do të thotë njëfarë mbështetjeje për të moshuarit pavarësisht nga sa kanë kontribuar, ose vetëm për ata që janë të varfër ose për të gjithë të moshuarit. Pastaj rekomandon shtyllën e parë, që është një pension i detyrueshëm i administruar publikisht, tipikisht një përfitim i përcaktuar. Shtylla e dytë është një kontribut pensioni, i detyrueshëm, i manaxhuar privatisht dhe shtylla e tretë është kontributi vullnetar. Shumica e vendeve të botës nuk i ka të gjitha këto shtylla të ndryshme. Ndërsa forma predominante e pensionit në botë ka të bëjë me një sistem përfitimi të detyrueshëm të manaxhuar publikisht për së paku një numër të caktuar të popullsisë, një numër vendesh me të ardhura të larta nuk e përfshijnë këtë komponent, duke i bërë ata më të ngjashëm me një variant të Opcionit 2 që sugjerohet më lart. Këtu përfshihen Australia, Islanda, Irlanda, Meksika, Holanda dhe Zelanda e Re.

Australia. Australia e nisi me një sistem pensionesh të financuar nga të ardhurat e përgjithshme, për të gjithë të moshuarit, plus sistemit privat suplementar të pensioneve mbi baza vullnetare. Duke qenë se garantimi i pensionit për të gjithë të moshuarit me kalimin e kohës u bë i shtrenjtë, Australia futi një metodë statistikore që testonte jo vetëm sistemin në mënyrë të hollësishme, por edhe të ardhurat e individëve, i cili u bën të mundur afërsisht dy të tretave të të moshuarve në Australi të marrin një pension publik, në vartësi të mjeteve të tyre të jetesës dhe aseteve, dhe jo domosdoshmërisht pension të plotë shtetëror. Aktualisht, një pension i plotë është afërsisht sa 25 përqind e pagës mesatare. Qeveria australiane nisi miratimin e sistemit privat suplementar të pensioneve në vitin 2001.

Islanda. Në Islandë, qeveria garanton një pension bazë prej 9 përqind të pagës mesatare dhe një pension shtesë prej 16 përqind të pagës mesatare dhe 7 përqind të pagës mesatare, që tërhiqen me rritjen e të ardhurave. Gjithashtu, qeveria ka miratuar sistemin privat suplementar të pensioneve.

Irlanda. Irlanda ofron opsione për tri pensionet bazë dhe mundësi e përfitimit për dy prej tyre varet nga vitet që personi ka kontribuar, ndërsa i treti është jokontributiv, por sipas testimit të të ardhurave. Të tri janë të ngjashëm për nga vlera, ku dy kontributivët zëvendësojnë afërsisht 30 përqind të pagës mesatare, ndërsa opsioni jokontributiv zëvendëson 28 përqind të pagës mesatare. Mund të përftohet vetëm një përfitim, me mosha të ndryshme të daljes në pension për periudha të ndryshme kontributi. Ndonëse në Irlandë përgjithësisht kërkohet kontributi, përfitimi nuk bazohet në të ardhurat personale apo kontributet, por është i njëjtë për të gjithë personat me të njëjtin numër vitesh kontributi. Gjithashtu, skemat e sistemit të pensioneve privat suplementare mbulojnë afërsisht 50 përqind të të punësuarve.

Meksiko. Meksikojka ka vetëm një sistem pensionesh private, me garanci nga shteti për individët që plotësojnë 25 vjet kontribute. Kjo masë garancie është në nivelin 100 përqind të pagës minimale të janarit të vitit 1997, të mabjtur konstante në terma reale dhe afërsisht 23 përqind e pagës së sotme mesatare.

Hollanda. Holanda garanton një pension bazë tek afërsisht 34 përqind e të ardhura mesatare me kërkesën që personat që punojnë duhet të kontribuojnë. Vlera e pensionit nuk bazohet tek paga apo shuma e kontributeve, por në vitet gjatë të cilave një individ ka kontribouar. Megjithatë, i njëjti pension është disponibël edhe për individët që nuk kanë kontribouar, por kjo bëhet me anë të testimit të të ardhurave të tyre. Gjithashtu, sistemi i pensioneve private suplementare mbulon 91 përqind të të punësuarve.

Zelanda e Re. Qeveria siguron një përfitim universal prej 38 përqind të të ardhurave mesatare për të gjithë rezidentët që kanë mbushur një moshë specifike, nga të ardhurat e përgjithshme, pa kërkesën për kontribut. Gjithashtu inkurajohet pjesëmarrja në sistemin e pensioneve private suplementare.

Gjithashtu, vende si Kanadaja dhe Danimarka që kanë të ardhura modeste në krahasim me pensionet publike garantojnë gjithashtu pensione të vogla universale, pavarësisht nga kontributet, përveç pensioneve për të moshuarit në nevojë. Ndërsa Zvicra, Suedia dhe Franca kanë si sistemet e pensioneve sociale për të moshuarit në nevojë dhe pensione publike të lidhura me të ardhurat, si edhe sistemet e pensioneve private suplementare.

VI. SIGURIMET AFATSHKURTRA

66. Përveç pensioneve, që përfaqësojnë sigurimet afatgjata, sistemet e sigurimeve shoqërore në Shqipëri gjithashtu ofrojnë sigurime afatshkurtra në rast sëmundjeje dhe leje lindjeje përmes Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Për sigurimet në rast sëmundjeje mbahet 0.8 përqind e pagës dhe 2.3 përqind mbahet për leje lindjeje. Gjithashtu, punëdhënësit paguajnë 0.5 përqind të borderosë për aksidente në punë dhe sëmundje profesionale.

67. Për sigurimet në rast sëmundjeje, 14 ditët e para të sëmundjes mbulojnë nga punëdhënësi, ndërsa sigurimi për sëmundjen fillon vetëm ditën e 15 të një sëmundjeje specifike dhe vazhdon deri në 6 muaj. Shuma e pagesës është 70 përqind e pagës së vitit të kaluar në rast se individit është i siguruar për më pak se 10 vjet dhe 80 përqind në rast se individit është i siguruar për mbi 10 vjet. Në rast se një individ i duhet të ndryshojë vend pune në një punë me pagë më të ulët si pasojë e sëmundjes, Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të paguajë dnë rast seerencën e pagave, deri në masën 50 përqind të pagës fillestare për një periudhë që zgjat deri në 3 muaj. Shpenzimet për këtë lloj sigurimi janë minimale dhe deri në vitin 2005 nga ky sigurim kanë përfituar vetëm 2,523 individë. Kohëzgjatja mesatare e përfitimeve nuk dihet, por nuk mund të jetë sinjifikative duke qenë se totali i shpenzimeve ka qenë vetëm 182 million lek, në krahasim me 40.2 miliardë lek që është për pensionet.

68. Po kështu, përfitimet për leje lindjeje mbulojnë një vit të plotë, me një minimum ditësh përpara lindjes dhe 42 ditë pas lindjes. Gratë marrin 80 përqind të pagës mesatare të vitit të fundit për 165 ditët e para të lejes së lindjes dhe 50 përqind për pjesën tjetër të periudhës. Ndërsa në vitin 2005 nga ky përfitim përfituan 10,193 gra, përfitimet gjithashtu duken të vogla në krahasim me shpenzimin e përgjithshëm për këtë përfitim tek vetëm 796 million lek.

69. Të dyja këto degë të sigurimeve shoqërore dalin vazhdimisht me teprica, të cilat i kalohen degës së pensioneve me qëllim mbulimin e deficiteve në këtë degë. Në rast se qeveria kërkon uljen e kërkesës për kontribute, kostoja reale e këtyre llojeve të sigurimeve mund të duhet të rivlerësohet. Gjithashtu, sigurimi për sëmundje të përkohshme mund të mbulojë siç ndodh në vende të tjera përmes akumulimit individual të ditëve të pashfrytëzuara për leje në rast sëmundjeje, që përbën një stimul për individët për të minimizuar përdorimin e tyre të ditëve të paguara nga punëdhënësi. Për lejen e lindjes, çështja është pak më e komplikuar. Përfitimet për leje lindjeje shpesh sigurohen nga punëdhënësit. Megjithatë, propabiliteti për pagesën e përfitimeve për lejen e lindjes mund të jetë element shkurajues për disa punëdhënës për të marrë në punë gra në moshat që lindin fëmijë. Rrjedhimisht ka argumente sipas të cilave përfitimi i pagesës për lejen e lindjes të mbahet në një organizatë të jashtme. Megjithatë, në rast se qeveria zgjedh Opcionin 2 për pensionet, që eliminon menjëherë ose në periudhën afatgjatë kontributet për pensionet, mund të mos ketë argumente të mjaftueshme për mbajtur një sistem sigurimesh shoqërore për këto degë me risk. Pagesa për paaftësinë që jepet nga Ministria e Punës mund të përmbledhë edhe këto risqe shtesë.

VII. PAGESA E PAPUNËSISË

70. Kontributet për pagesën e papunësisë mblidhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe teorikisht transferohen në Fondin Kombëtar të Punësimin, që administron përfitimet. Praktikisht, qeveria e lejon Institutin e Sigurimeve Shoqërore të mbajë të ardhurat në vend të një pjese të kontributit që i takon të bëjë për të punësuarit në sektorin rural dhe i kalon shumat që nevojiten për të paguar përfitimet direkt nga buxheti tek Fondi Kombëtar i Punësimin. Një përqindje kontributi prej 5 përqind e borderosë, që është reduktuar në 2 përqind, paguhet nga punëdhënësit për këtë përfitim.

71. Për të përfituar pagesën, një individ i duhet të ketë 12 muaj kontribute, të ketë qenë aktivisht në kërkim të një vendi pune dhe të mos i takojë përfitim tjetër afatgjatë apo afatshkurtër për sigurime shoqërore, me përjashtim të përfitimit për paftësi të pjesshme. Përfitimi është një shumë fikse, pavarësisht nga pagat e mëparshme dhe kontributet dhe aktualisht është përcaktuar nga Këshilli i Ministrave në nivelin 37.5 përqind të pagës minimale. Një shumë prej 5 përqind më shumë mbi përfitimin paguhet për çdo fëmijë në moshën 15 vjeçare ose më poshtë që jeton me të papunin, si edhe kompensime shtesë për bukën dhe faturën e energjisë elektrike. Totali i pagesës arrin mesatarisht në afërsisht 50 përqind të pagës minimale dhe është dyfishi i nivelit të pagesës së ndihmës ekonomike.

72. Përfitimet zakonisht jepen për një periudhë 12 mujore. Megjithatë, në rast se një aplikant del i papunë për të dytën herë brenda 2 vjetëve nga marrja e përfitimit, pagesa bëhet vetëm për 10 muaj. Dhe në rast se aplikanti del i papunë për herë të tretë brenda 2 vjetëve nga marrja e përfitimit të dytë për papunësinë, periudha e pagesës kufizohet në vetëm 8 muaj. Gjatë periudhës së marrjes së përfitimeve, Fondi Kombëtar i Punësimin i paguan kontribute Institutit të Sigurimeve Shoqërore në emër të punëtorëve në mënyrë që i punësuarit të mos humbë kreditet e shërbimit për atë periudhë kohore.

73. Afërsisht 11,000 individë nga 153,000 të papunë të regjistruar në Shqipëri përfitojnë pagesën e papunësisë. Pjesa dërmuese që mbetet përfiton pagesë nga Ndihma Ekonomike. Programi është përdorur për të mbështetur punëtorët që kanë dalë të papunë nga privatizimi i ndërmarrjeve shtetërore. Këta punëtorë shpesh marrin një pagesë për kompensim deri për 2 vjet.

74. Për të mbështetur këtë pagesë duhen gjashtëdhjetë deri 70 përqind e të ardhurave nga kontributet e 5 përqind të pagës. Ulja e kohëve të fundit në 2 përqind të pagës mund të mos jetë e mjaftueshme për të mbuluar këtë pagesë. Në rast se nevojiten burime fiskale për të kompensuar kontributet e pagave, lind pyetja se përse disa individë marrin pagesë për papunësi dhe të tjerët që paguajnë taksat por jo kontributet nuk marrin.

75. Si në rastin e kontributit për pensionet, fokusi i kësaj pagese është ulja e varfërisë dhe jo zbutja e konsumit. Ndërsa të punësuarve që kontribuojnë u takon vetëm një shumë fikse, sistemi nuk përmban stimuj për deklarimin real të pagave mbi nivelin minimal të pagës, duke inkurajuar kështu sërish mos deklarimin real të pagave.

76. Në rast se qeveria zgjedh të korigjojë sistemin kontributiv të pensioneve për t'u dhënë individëve stimuj për të marrë pjesë në sistem, qeveria mund ta aplikojë këtë gjë edhe për rastin

e sigurimeve për pagesën e papunësisë. Brenda të njejtës paketë fiskale, mund të ulet kohëzgjatja e përfitimeve, ndërsa shumat të rriten.

77. Në rast se qeveria zgjedh ta anullojë sistemin kontributiv të pensioneve, mund të duhet të marrë në konsideratë anulimin gjithashtu edhe të programit, duke qenë se individët në nevojë mund të përfitojnë nga Ndihma Ekonomike. Niveli i përfitimeve në këtë program është kaq i ulët sa që nuk përbën opcion atraktiv për të punësuarit me të ardhura të mesme apo të larta të cilët dalin të papunë dhe për të punësuarit me të ardhura të ulta ekziston tashmë programi i ndihmës ekonomike.

VIII. SIGURIMET SHËNDETËSORE

78. Sigurimet shëndetësore, që janë ndarë nga sigurimet shoqërore në Shqipëri, po përballen aktualisht me problemet me të cilat do të ndeshet sistemi i pensioneve në të ardhmen. Ndryshe nga rasti i pensioneve, ku përfituesit aktualë i marrin përfitimet sipas kontributeve që kanë bërë në të kaluarën, që në shumicën e rasteve janë të plota, përfituesit nga sigurimet shëndetësore i marrin përfitimet kryesisht bazuar në kontributet aktuale. Duke qenë se vetëm një përqindje e kufizuar e krahut të punës jep aktualisht kontribute për sigurimet shoqërore, rrjedhimisht vetëm një përqindje e kufizuar e popullsisë mund të përfitojë nga sigurimet shëndetësore. Rrjedhimisht, përqindja e shpenzimeve për kujdesin shëndetësor në sektorin privat në Shqipëri është 61 përqind, që është shumë më e lartë se mesatarja për ECA-n prej 33 përqind dhe mbi mesataren e vendeve me të ardhura të ulta dhe të mesme në botë prej 54 përqind dhe për vendet me të ardhura të larta prej 42 përqind. Rrjedhimisht, një përqindje e lartë e popullsisë përballlet me riskun e varfërisë kur përballen me një sëmundje që kërkon trajtim.

79. Për më tepër, duke qenë se Ministria e Shëndetësisë ofron kujdesin spitalor, individët që nuk janë të siguruar me sigurimet shëndetësore shpesh përfundojnë tek spitalet, në vend që të përdorin shërbimet e ofruara nga kujdesi shëndetësor parësor që janë më të lira, dhe të cilat financohen ose nga sigurimet shëndetësore ose nga pikat e arkëtimit të pagesave nga përfituesit e shërbimeve. Rrjedhimisht, mungesa e mbulimit nga sistemi i sigurimeve shëndetësore po çon në probleme serioze me akordimin jo siç duhet të fondeve në sisetmin shëndetësor. Dokumenti për Sektorin Shqiptar të Shëndetësisë i muajit shkurt të vitit 2006 flet me detaje mbi këtë dhe të tjera çështje të sektorit të shëndetësisë.

80. Së fundi, nga totali i shpenzimeve për sektorin publik të shëndetësisë, 93 përqind vjen nga buxheti i shtetit. Dy të tretat nga këto janë shpenzime të Ministrisë së Shëndetësisë, që teorikisht u ofrohen të gjithë shqiptarëve, ndonëse në praktikë ka pengesa gjeografike dhe të ndonjë natyre tjetër. Megjithatë, një e katërta e këtyre shpenzimeve publike janë shpenzime nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor (ISKSH). Këto shpenzime janë të kufizuara vetëm për individët e mbuluar nga sigurimet shëndetësore, që përfaqësojnë afërsisht 40 përqind të popullsisë. Por të ardhurat për financimin e pjesës më të madhe të këtij shpenzimi vijnë nga buxheti. Buxheti është i detyruar të kontribuojë për të punësuarit në sektorin publik, fëmijët nën një vjeç, gratë shtatëzëna, veteranët e luftës, të paafët, të papunët dhe përfituesit e asistencës sociale, të sëmurët me kancer, ushtarët dhe pensionistët. Fondet buxhetore, që mbledhen nga një bazë e gjerë e popullsisë, rrjedhimisht përdoren për të mbështetur shpenzimet për një segment të kufizuar të saj.

81. Rekomandimet që vijnë nga Dokumenti për Sektorin e Shëndetësisë janë afërsisht të njehta me ato për sistemin e pensioneve. Një opcion që rekomandohet është marja në konsideratë e kalimit drejt një sistemi publik të financimit të shëndetësisë, që bazohet vetëm tek tatimet e përgjithshme në vend të tatimit të pagës. Ky opcion është paralel me Opcionin 2 për sistemin e pensioneve, ku rekomandimi është heqja e sistemit kontributiv dhe kalimi drejt një pensioni pleqërie që financohet nga të ardhurat e përgjithshme. Megjithatë, ka një diferencë midis dy llojeve të sigurimeve. Përfitimet e pensionit, njësoj si pagesa e papunësisë, kanë si objektiv zbutjen e konsumit përveç uljes së varfërisë. Një pension me shumë fikse nuk do ta arrijë atë objektiv dhe do të duhet të shoqërohet nga një sistem vullnetar pensionesh, që bën të mundur

zbutjen e konsumit. Në sektorin e shëndetësisë ekuivalenti do të ishte që qeveria të ofronte një paketë gjithëpërfshirëse bazë shëndetësore dhe jo thjesht kujdesin spitalor dhe t'u lejonte individëve të blinin shërbime shtesë nëpërmjet tarifave të shërbimit ose nëpërmjet blerjes së shërbimeve shëndetësore shtesë.

82. Opcioni i dytë që parashtrohet në Dokumentin e Sektorit të Shëndetësisë është futja e një pakete përfitimesh me dy nivele, ku të ketë një paketë bazë të financuar nga të ardhurat e përgjithshme për të gjithë individët dhe nga ana tjetër të mbahet një paketë e zgjeruar për përfitimet për individët që i bëjnë vetë kontributet e sigurimeve shëndetësore. Ky rekomandim është paralel me Opcionin 1 për pensionet, ku individët që kontribuojnë mund të sigurojnë si uljen e varfërisë dhe zbutjen e konsumit përmes sistemit publik të pensioneve, ndërsa ata që nuk kontribuojnë marrin një pension bazë që garantohet përmes të ardhurave të përgjithshme.

83. Megjithatë, duke qenë se këto dy degë të sigurimeve shoqërore janë substancialisht të ndryshme nuk është e nevojshme të miratohen politika paralele për të dyja llojet e sigurimeve, sidomos duke qenë se autoritetet tatimore përgjigjen për pjesën dërmuese të arkëtimit të kontributeve. Rrjedhimisht, Opcioni 1 për pensionet mund të qëndronte gjithësesi vetëm me sistemin e financimit të shëndetit publik dhe Opcioni 2 për pensionet mund të bashkëekzistonte me një sistem me dy nivele të financimit të shëndetësisë. Në rast se autoritetet tatimore nuk do të përgjigjeshin për mbledhjen e kontributeve, ekonomitë e shkallës në administrim mund të inkuarjonin përdorimin e sistemeve paralel në degë të ndryshme të sigurimeve shoqërore, por në këtë rast ekonomitë e shkallës realizohen nga autoritetet tatimore.

IX. KONKLUZIONET

84. Sistemi i sigurimeve shoqërore në Shqipëri ndërsa mbulon sigurimet për sëmundjet afatshkurtra, lejen e lindjes, pagesën për papunësinë, kostot për shëndetin dhe pensionet, kryesisht përqëndrohet tek këto të fundit. Shumica e të ardhurave shkojnë për sistemin e pensioneve dhe shumica e shpenzimeve gjithashtu drejtohet drejt pensioneve. Megjithatë, në modelin aktual të sistemit të pensioneve ka mangësi të mëdha, të cilat evoluojnë si arnime për të korrigjuar problemet e mëparshme.

85. Qeveria tani e gjen veten në një udhëkryq përse i përket modelit të pensioneve dhe i duhet të ristrukturojë rrenjësisht sistemin aktual, duke eliminuar shumë ose pjesën më të madhe të mangësive aktuale, por kjo do ta linte sërisht sistemin një sistem me kosto relativisht të larta borderoje dhe segmente të mëdha të popullsisë të pambrojtura nga risqet e ndryshme. Nga ana tjetër, qeveria mund të zgjedhë të heqë sistemin kontributiv, duke eliminuar kostot e larta të borderove dhe duke u përqëndruar tek ofrimi i përfitimeve për uljen e varfëris kundrejt shumë risqeve me të cilat mund të përballet një individ, por kjo nuk do të siguronte mjete për zbutjen e ndjeshme të konsumit.

86. Çfarëdo vendimi që të marrë qeveria në lidhje me sistemin e pensioneve, ai do të ketë implikime për degët e tjera të sigurimeve shoqërore. Shumica e këtyre risqeve të tjera mundet ose të mbulohen nga shteti në nivelin e uljes së varfërisë ose mund të mbulohen direkt nga punëdhënësit në rast se nuk do të kishte sistem kontributiv pensionesh. Nga ana tjetër, në rast se do të vazhdohet me sistemin kontributiv të pensioneve, secila nga këto degë të sigurimeve duhet të vlerësohet për të përcaktuar nivelin e duhur të kontributit që kërkohet dhe mund të vazhdohet me një pjesë ose me të gjithin. Në këtë rast, një vlerësim i mëtejshëm duhet të përcaktojë nëse personat e mbuluar nga sigurimet zyrtare shoqërore gjithashtu duhet të jenë të mbuluar përkundrejt një risku të caktuar dhe të përcaktojë gjithashtu nëse ky duhet ofruar ndoshta përmes pagesës në kuadrin e Ndihmës Ekonomike.

ANEKSET

Të gjitha simulimet dhe parashikimet në këtë dokument janë përgatitur duke përdorur modelin PROST të Bankës Botërore. PROST (Paketa për Simulimet e Reformave në Sistemin e Pensioneve) është një model i përgjithshëm projeksionesh në kompjuter personal, i përpiluar nga njësia e Mbrojtjes Sociale në Bankën Botërore.

Modeli është hartuar për të simuluar sjelljen e sistemeve të pensionit dhe mund të bëjë një vlerësim të qendrueshmërisë së tyre financiare në situata të ndryshme supozimesh për një periudhë afatgjatë. Ky model lejon modelimin e opcioneve të ndryshme të reformave në sistemin e pensioneve – nga reformat parametrike të skemave të tipit ku pagesat bëhen nga të ardhurat e arkëtuara deri tek reformat e sistemit, si p.sh. futja e skemave të kontributit të përcaktuara plotësisht. Programi mund të përshtatet ndaj një game të gjerë rrethanash të vendit dhe mund të përfshijë periudha simulimi prej 100 vjet ose edhe më shumë.

Si në çdo rast modeli simulimi, rezultatet e PROST-it varen shumë nga natyra dhe cilësia e të dhënave, si edhe nga një set supozimesh që është përdorur për simulimet. Duke qenë se modeli PROST është përdorur në afërsisht 80 vende për input sasior në diskutimet mbi politikat e pensioneve, metodologjia e tij ka rezultuar e shëndoshë dhe fleksibiliteti që paraqet ka bërë të mundur një përshtatje të lehtë ndaj rrethanave të çdo vendi për sa i takon testimin të ndjeshmërisë ndaj tij dhe krahasimeve në një gamë të gjerë skenarësh ekonomikë dhe të politikave.

Në rastin e Shqipërisë ekzistojnë disa shqetësime serioze në lidhje me vlefshmërinë e disa prej shifrave, si p.sh. numri i madh i të moshuarve që marrin pension, që është shumë më i lartë nga shifra e popullsisë. Megjithatë, duke qenë që del se të dhënat e siguruara janë në përputhje me shumën e shpenzimeve për pensionet dhe shumën e përfitimeve që ofrohen, ato përdoren në simulim si të dhëna. Me kalimin e kohës, kur PROST-i të aplikojë përqindjet e vdekshmërisë për pensionistët aktualë, numri i pensionistëve do të bjerë në nivele më normale, me gjithmonë e më pak pensionistë në moshat më të mëdha.

PROST-i ndjek kohortën sipas gjinisë/moshës me kalimin e kohës dhe bën parashikime për popullsinë që bashkë me supozimet për tregun e punës përdoren për të parashikuar shifrat e ardhshme të kontribuesve dhe përfituesve. Këto nga ana e tyre parashikojnë rrjedhjen e të ardhurave dhe shpenzimeve. Pastaj modeli bën parashikime të balancave fiskale.

Të gjitha të dhënat dhe supozimet që kërkohen nga PROST-i për parashikimet për popullsinë janë marrë nga Njësia e Popullsisë në Bankë: popullsia fillestare sipas moshës dhe gjinisë dhe parashikimet e koeficientëve specifikë të moshës për pjellorinë, koeficientët e vdekshmërisë dhe lëvizjet migratore. Megjithatë, këto janë krahasuar me të dhënat e Departamentit të Popullsisë së Kombeve të Bashkuara, si edhe me të dhënat e mbledhura nga INSTAT-i në Shqipëri dhe të gjitha u gjetën se përputheshin. Piramidat e popullsisë për vitin 2004 dhe ato të parashikuara për vitin 2075 paraqiten në Figurat A.1 dhe A.2. Siç mund të vihet re nga Figura A.1, pjesa dërmuese e popullsisë shqiptare është e re; në vitin 2075, siç vërehet në Figurën A.2, struktura demografike do të ndryshojë drejt një strukture shumë më uniforme të moshës.

Figura A.1: Piramida e popullsisë për Shqipërinë në vitin 2004





Figura A.2: Piramida e parashikuar për popullsinë në Shqipëri në vitin 2075




Këto parashikime janë nxjerrë nga shifrat fillestare të popullsisë, me ndryshimin e popullsisë ndër vite sipas ndryshimeve në pjellori dhe vdekshmëri gjatë jetës. Supozimet për vdekshmërinë paraqesin ndryshimet në pritshmërinë jetike të paraqitura në Tabelën A.1. Gjithashtu, edhe totali i koeficientit të pjellorisë të supozuar ndryshon gjatë periudhës së simulimit dhe paraqitet gjithashtu në Tabelën A.1. Në planin ndërkombëtar objektivi është sigurimi i pensioneve për një periudhë afërsisht 15 vjeçare. Pritshmëria jetike në Shqipëri për meshkujt është 15 vjet në moshën 65 vjeçare për vitin 2006 shumë përpara se mosha e daljes në pension të bëhet 65 vjeç. Në atë moment, mosha e daljes në pension për burrat arrin 65 vjeç; pritshmëria jetike në moshën 65 vjeçare është afërsisht 16 vjet, gjë që sugjeron që moshat e daljes në pension si për burrat, ashtu edhe për gratë në të ardhmen në Shqipëri duhet të rriten.

Tabela A.1: Jetëgjatësia e parashikuar dhe totali i pjellshmërisë për vite të ndryshme

	2004	2005	2006	2010	2025	2050	2075
Meshkuj							
<i>Pritshmëria jetike</i>							
Në lindje	71.5	71.9	72.3	73.9	76.3	77.5	79.0
Në moshën 20 vjeç	54.1	54.4	54.7	56.0	57.9	58.6	59.6
Në moshën 60 vjeç	18.2	18.4	18.6	19.6	21.0	21.6	22.4
Në moshën 65 vjeç	14.6	14.8	15.0	15.8	17.1	17.6	18.4
Femra							
<i>Pritshmëria jetike</i>							
Në lindje	76.3	76.6	77.0	78.5	81.0	83.0	85.2
Në moshën 20 vjeç	58.2	58.5	58.8	60.0	62.1	63.7	65.6
Në moshën 60 vjeç	20.9	21.1	21.4	22.4	24.0	25.4	26.9
Në moshën 65 vjeç	16.9	17.1	17.3	18.2	19.7	21.0	22.3
Koeficienti total i pjellshmërisë	228.9%	227.2%	225.5%	218.8%	209.7%	208.6%	207.5%

Në model kontribuesit llogariten si përqindje e popullsisë specifike sipas gjinisë/moshës. Këto raporte mbahen konstante gjatë gjithë periudhës së simulimit. Për sektorin urban nuk dihet përbërja ekzakte e kontribuesve. Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka ofruar informacionin e marrë nga një model simulimi. Për sektorin rural jepen moshat dhe gjinitë e kontribuesve. Figura A.3 tregon përqindjen e kontribuesve për çdo grup sipas moshës dhe gjinisë në sektorin urban. Siç mund të vihet re, përqindjet e kontributeve janë tepër të ulta për të punësuarit me moshë të re. Vetëm në 10 vjetët e fundit përpara daljes në pension rriten përqindjet e kontributit, duke qenë se të punësuarit përpiqen të përfitojnë nga pensioni i pleqërisë.


Figura A.3: Kontribuesit në Sistemin Urban në Shqipëri si përqindje e kohortës specifike të popullsisë sipas moshës-gjinisë në vitin 2004



Duke kaluar tek përfituesit, nuk ka të dhëna specifike për përfituesit ruralë. Sapo ka përfunduar një regjistrim popullsie për pensionistët e moshuar në sektorin urban dhe kjo shpërndarje është përdorur për të përlllogaritur shpërndarjen moshore për pensionistët në sektorin rural. Për pensionistët me paaftësi dhe ata të mbetur të ve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore kishte vetëm të dhëna të simuluar për të përlllogaritur shpërndarjen moshore për pensionistët me


paaftësi dhe të mbetur të ve vetëm për sektorin urban. Këto shpërndarje janë përdorur gjithashtu për sektorin rural ku numri i pensionistëve për scielin nga tipet është i njohur, por nuk dihet shpërndarja moshore. Megjithatë, duhet theksuar se modeli PROST i përdor këto të dhëna ndryshe nga të dhënat për kontribuesit. Ndërsa modeli PROST i lejon përdoruesit të supozojë që kontribuesit si përqindje e grupmoshës mbeten të pandryshuar me kalimin e kohës, përfituesit në të ardhmen llogariten duke ndjekur kohortën e kontribuesve, duke qenë se kontribuesit e sotshëm janë përfituesit e ardhshëm. Figura A.4 më poshtë tregon shpërndarjen për vitin 2004 të pensionistëve të moshuar në sektorin urban. Të dhënat jepen vetëm për meshkujt duke qenë se inflacioni i shifrave për numrin e pensionistëve është kryesisht për meshkujt, ndërsa për gratë nuk del fare duke patur parasysh shkallën që kërkohet për të dhënat për meshkujt. Të dhënat për meshkujt gjithashtu priten në moshën 96 vjeçare, duke qenë se në moshën më të mëdha vlerat/shifrat janë më të larta dhe e ngatërrojnë tërësisht shkallën e grafikut.

Figura A.4: Pensionistët e moshuar meshkuj në sektorin urban në vitin 2004




Numri i pensionistëve që përfitojnë pagesë paaftësie në Shqipëri është shumë i vogël, sikundërse përmendet edhe në tekst. Figura A.5 tregon pensionistët me paaftësi burra dhe gra në sektorin urban, sipas të dhënave të modelit të ofruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Figura A.5: Pensionistët me paaftësi në sektorin urban në vitin 2004



Pensionistët e mbetur të ve paraqiten në are shown Figurën A.6. Siç edhe pritet, ata janë kryesisht gra, por në disa moshë të caktuara ato arrijnë në një përqindje relativisht të lartë të popullsisë. Kjo është edhe më e dukshme sepse këto shifra të përfituesve janë vetëm për sektorin urban, ndërsa shifrat e popullsisë janë për të gjithë vendin. Në këtë dokument nuk paraqiten shifra për jetimet duke qenë se nuk përbëjnë ndonjë element me interes të veçantë.

Figura A.6: Pensionistët të mbetur të ve, sektori urban, viti 2004



Të dhënat e paraqitura këtu nxjerrin padyshim në pah vështirësitë e bërjes së parashikimeve dhe analizave kur të dhënat nuk janë të plota. Këto të dhëna janë përdorur si pikë nisjeje për analizat në mungesë të alternativave të tjera. Megjithatë, rezultatet janë produkt i të dhënave dhe duhen parë me një farë maturie/kujdesi. Të dhënat gjithashtu tregojnë për nevojën e hartimit të një baze të dhënash më të mirë statistikore në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Supozimet e përdorura për analizën e shpërndarjes që bën një krahasim të ndikimit të sistemit të pensioneve për pensionistë me nivele të ndryshme të ardhurash paraqiten në Tabelën A.2. Ndonëse nuk ka asnjë bazë empirike për këto vlera specifike në Shqipëri, qëllimi i tyre është të ilustrojnë dallimet midis individëve. Duke qenë se ka kontribues që nisin punën që në moshën 16 vjeçare, supozimi bëhet që individët me të ardhura të ulta, pa arsim të lartë janë ata që e nisin në atë moshë (kontributin). Ndërsa individët që vazhdojnë arsimin e lartë mund të mos nisin kontributet përpara moshës 25 vjeçare. Për të gjithë këta supozimi bëhet që punën ta vazhdojnë pa shkëputje dhe që dalin në pension në moshën e përcaktuar me ligj. Duke qenë se individët me të ardhura të ulta kanë nivele më të larta vdekshmërie, sesa ata me të ardhura të larta, janë marrë parasysh koeficientë të ndryshëm vdekshmërie. E njëjta gjë përdoret për pagën fillestare dhe për modelet e rritjes së pagave. Megjithatë, specifikimi ekzakt duhet të merret thjesht si ilustrim.

Tabela A.2: Supozimet e përdorura në analizat e shpërndarjes

	Me të ardhura të larta	Të ardhura të mesme	Të ardhura të ulta
Mosha kur ka filluar punë	25	21	16
Mosha e daljes në pension	65M/60F	65M/60F	65M/60F
Përqindjet e vdekshmërisë si % e koeficientëve kombëtarë specifikë për moshën	90%	100%	120%
Paga fillestare si % e mesatares së kohortës	150%	100%	50%
Rritja vjetore e pagës si % e rritjes mesatare të pagës së moshës specifike	120%	100%	50%

REFERENCAT

Hamermesh, Daniel S. Labor Demand. Princeton University Press: 1996.

Holzmann, Robert and Hinz, Richard. Old Age Income Support in the 21st Century: An International Perspective on Pension Systems and Reforms. Washington, D.C.: World Bank, 2005.

Pensions at a Glance: Public Policies Across OECD Countries. OECD: 2005.

wb80595
P:\ALBANIA\HD\GENERAL\Social Insurance Review\AL-SIR-Dec5'06final[1].doc
2007-03-13 5:39:00.MD